

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



DEPARTAMENTI I INSTITUCIONEVE QENDRORE  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK I USHTRUAR NË  
MINISTRINË E KULTURËS DHE CIRKUN KOMBËTAR

## **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**PËR AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË  
MINISTRINË E KULTURËS DHE CIRKUN KOMBËTAR**

**JANAR 2022**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
<b>II.</b>	<b>HYRJE</b>	<b>7</b>
1.	Objekti i auditimit	7
2.	Qëllimi i auditimit	7
3.	Identifikimi i çështjes	7
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
5.	Përgjegjësitë e audituesve	7
6.	Kriteret e vlerësimit	8
7.	Standardet e auditimit	9
8.	Metodat e auditimit	9
9.	Dokumentimi i auditimit	9
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>10</b>
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	10
2.	Përshkrimi i i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	11
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>35</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSET</b>	<b>39</b>
<b>VI.</b>	<b>LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT</b>	<b>39</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori përputhshmërinë me kriteret e vlerësimit përfshirë ligjet, rregulloret, udhëzimet e procedurave të ndjekura nga Ministria e Kulturës dhe Cirkut Kombëtar në zbatim të autorizimit nr. 1129/2 Prot., datë 25.10.2021 dhe autorizimit nr. 1129/4 Prot., datë 12.11.2021 të Kryetarit të KLSH-së për kryerjen e auditimit tematik, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me:

- Procedurat e ndjekura për tjetërsimin e pronës, ku ushtrohej më parë aktiviteti i Cirkut të Tiranës (finalizuar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 8473, datë 17.12.2019) në Ministrinë e Kulturës;
- Zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave në institucionin e Cirkut të Tiranës;
- Procedura e dokumentimit, ruajtjes, qarkullimit dhe nxjerrjes nga përdorimi i kaldajës së institucionit; dhe
- Zbatimi i dispozitave ligjore në procedurën e emërimit të Drejtorit të Cirkut Kombëtar Z. I.GJ..

Cirku Kombëtar është person juridik me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën. Cirku Kombëtar ka objekt të veprimtarisë së tij, mbështetjen në vlerat e kulturës dhe artit kombëtar, si dhe në vlerat më të mira të kulturës dhe artit botëror. Cirku Kombëtar organizohet dhe funksionin në zbatim të Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 ÷Për Artin dhe Kulturën.

Cirku Kombëtar është pronë shtetërore, regjimi juridik i të cilit rregullohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 ÷Për pronat e paluajtshme shtetërore, i ndryshuar. Në vitin 2011, Këshilli i Ministrave, me anë të VKM-së nr. 458, datë 22.06.2011 ÷Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të pronës nr. 276, ÷Cirku i Tiranës, në juridiksion të Bashkisë së Tiranës.ö

### 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga shqyrtimi i fashikullit të gjykimit të procesit gjyqësor me palë paditëse Shoqëria ÷Uö shpk dhe palë e paditur Cirku Kombëtar, rezulton se janë zhvilluar 15 seanca gjyqësore dhe vetëm për 2 prej tyre rezulton të ketë memo informuese nga ana e juristes së Ministrisë së Kulturës znj. J.S., drejtuar Drejtorit të	Më hollësisht trajtuar në faqet (10-20) të Raportit të Auditimit	E lartë	Ministria e Kulturës dhe Cirku Kombëtar të marrin masa që të kenë informacion nga përfaqësuesit e autorizuar, për çdo seancë, në lidhje me ecurinë e proceseve gjyqësore dhe njëkohësisht të marrin masa që

	<p>Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, i cili është përgjegjës për sektorin e ankesave administrative dhe gjyqësore dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Në lidhje me seancat e tjera të zhvilluara nuk rezultoi të ketë asnjë informacion se çfarë ka ndodhur gjatë shqyrtimit gjyqësor në këto seanca, në shkelje të përcaktimeve të pikës 3 të nenit 46 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës. Po kështu, rezultoi që përfaqësuesit e autorizuar kanë munguar në 2 seancat e fundit gjyqësore dhe në këto kushte gjykata ka shtyrë seancat gjyqësore për shkak të mungesës së përfaqësueses së palë së paditur Cirkut Kombëtar.</p>			<p>përfaqësuesit ligjor të institucionit të jenë prezent në çdo seancë gjyqësore në proceset në ndjekje.</p>
2.	<p>Nga auditimi u konstatua se, Vendimi nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është protokolluar pranë Cirkut Kombëtar me nr. 26, datë 17.01.2020 dhe duhet të ishte ankimuar brenda 03.02.2020, sipas parashikimeve të nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile.</p>	<p>Më hollësisht trajtuar në faqet (10-20) të Raportit të Auditimit</p>	E lartë	<p>Cirku Kombëtar të hartoj një metodologji për procedurën e dërgimit të praktikave protokollare të titullari i institucionit dhe kalimin e këtyre praktikave të strukturat përgjegjëse për trajtim, me qëllim</p>

				dokumentimin e procesit dhe përcaktimin e përgjegjësive.
3.	<p>Nga auditimi i procedurës së emërimit të drejtorit të Cirkut Kombëtar z. I.GJ., rezulton se ai është emëruar me anë të VKM-së nr. 858, datë 24.12.2019 òPër emërimin në detyrë të Drejtorit të Cirkut Kombëtarò. Grupi i auditimit kërkoi pranë Ministrisë së Kulturës dosjen me dokumentacionin mbështetës dhe procedurën e konkurrimit për emërimin e Drejtorit të Cirkut Kombëtar. Dokumentet e vetme të vëna në dispozicion në lidhje me këtë çështje ishin VKM-ja nr. 858 e miratuar dhe relacioni i Ministrisë së Kulturës për òProjektvendimin për emërimin në detyrë të Drejtorit të Cirkut Kombëtarò, ku theksohet se në kushtet e nevojës emergjente për caktimin e një titullari në Cirkun Kombëtar, propozohet kandidatura në fjalë pa ndonjë procedurë konkurrimi. Në mungesë të zhvillimit procedurës së konkurrimit nga ana e Ministrisë së Kulturës, nuk janë plotësuar kërkesat e Nenit 9/3 të Ligjit 10352, datë 18.11.2010 òPër artin</p>	Më hollësisht trajtuar në faqet (32-34) të Raportit të Auditimit	E lartë	Ministri i Kulturës të marrë masa për të çelur dhe zhvilluar procedurën e konkurrimit për zgjedhjen e Drejtorit të Cirkut Kombëtar dhe propozimin e kandidaturës fituese pranë Këshillit të Ministrave për emërim, në përputhje me nenin 9/3 të Ligjit 10352, datë 18.11.2010 òPër artin dhe Kulturënò, i ndryshuar.

	dhe Kulturënö, i ndryshuar, i cili parashikon se ðEmërimi i titullarit të institucionit publik qendror bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave pas procedurave të konkurrimit të zhvilluara nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën.ö			
4.	Nga auditimi ka rezulton se ka kaluar afërisht 1 vit që nga njoftimi për ekzekutim vullnetar të detyrimit dhe nga ana e Cirkut Kombëtar nuk është ndërmarr asnjë veprim ligjor në lidhje me këtë shkresë të përmbaruesit gjyqësor, e cila ka sjell pasoja shumë të rënda për institucionin dhe njëkohësisht për buxhetin e shtetit. Detyrimi i përcaktuar në urdhrin e vendosjes së masës së sekuestros konservative, që lidhet me vlerën e përdorimit të pronës për periudhën 28.05.2019-28.05.2021, në masën 7,903,272 (shtatëmilion e nëntëqind e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, konsiderohet si dëm ekonomik në buxhetin e shtetit. Drejtori i Cirkut Kombëtar nuk ka ndërmarr asnjë masë në lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve që lidhen me Vendimin nr. 8473, datë 17.12.2019. Në asnjë	Më hollësisht trajtuar në faqet (10-20) të Raportit të Auditimit	E lartë	Ministria e Kulturës të kërkoj arkëtimin e vlerës 7,903,272 (shtatëmilion e nëntëqind e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, si dëmshpërblim për vlerën e përdorimit të pronës për periudhën 28.05.2019-28.05.2021, në masën 7,903,272 (shtatëmilion e nëntëqind e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për shkak të mosveprimit të Drejtorit të Cirkut Kombëtar Z. I.GJ..

	moment nuk është ngritur një grup pune me qëllim marrjen masave për ndjekje e këtij procesi.			
--	--	--	--	--

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 ðPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHö, në zbatim të Autorizimit të autorizimit nr. 1129/2 Prot., datë 25.10.2021 dhe autorizimit nr. 1129/4 Prot., datë 12.11.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 25.10.2021 deri në datë 24.11.2021 në subjektin Ministria e Kulturës dhe Cirku Kombëtar për periudhën nga data 01.01.2019 deri më datën 30.09.2021 u krye auditim tematik nga Grupi i Auditimit me përbërje: ÉF.XH., Përgjegjës Grupi ÉK.A., Auditues

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

**Objekti i auditimit:** lidhet me vlerësimin e ligjshmërisë në lidhje me; procedurat e ndjekura për tjetërsimin e pronës, ku ushtrohej më parë aktiviteti i Cirkut të Tiranës, (finalizuar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 8473, datë 17.12.2019) në Ministrinë e Kulturës; zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave në institucionin e Cirkut të Tiranës; procedurave të dokumentimit, ruajtjes, qarkullimit dhe nxjerrjes nga përdorimi i kaldajës së institucionit dhe zbatimin e dispozitave ligjore në procedurën e emërimit të Drejtorit të Cirkut Kombëtar Z. I.GJ..

**Qëllimi i auditimit:** është dhënia e opinionit apo lëshimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

### **Identifikimi i çështjes**

Verifikimi i procedurave si dhe kriteret e ndjekura gjatë procesit për tjetërsimin e pronës, ku ushtrohej më parë aktiviteti i Cirkut të Tiranës (finalizuar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 8473, datë 17.12.2019) në Ministrinë e Kulturës; zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave në institucionin e Cirkut të Tiranës; procedurat e dokumentimit, ruajtjes, qarkullimit dhe nxjerrjes nga përdorimi i kaldajës së institucionit dhe zbatimi i dispozitave ligjore në procedurën e emërimit të Drejtorit të Cirkut Kombëtar, janë çështjet e trajtuara në këtë auditim me qëllim vlerësimin dhe evidentimin nëse veprimtaria e Ministrisë së Kulturës dhe Cirkut Kombëtar është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, mbi bazën e të cilave këto institucione ushtrojnë aktivitetin, në mënyrë të tillë që të bëhet e mundur ndërmarrja e veprimeve korrigjuese sipas rastit.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Ministri i Kulturës ka përgjegjësi në lidhje me emërimin pa konkurrim të Drejtorit të Cirkut Kombëtar z. I.GJ..

Drejtori i Cirkut Kombëtar ka përgjegjësi për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit, në

lidhje me administrimin e vendimit gjyqësor dhe shkresave të përmbarimit, si dhe administrimin e aktiveve të institucionit të cilat kanë sjell pasoja për institucionin.

Drejtori i Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve dhe juristët e autorizuar të Ministrisë së Kulturës për ndjekjen e proceseve gjyqësore, kanë përgjegjësi për përfaqësimin dhe koordinimin efektiv në të gjitha shkallët e gjyqimit për çdo proces gjyqësor të autorizuar.

### **Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të garantohet siguri e arsyeshme mbi përputhshmërinë e detyrimeve kontraktuale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e natyrore të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjen që është nën auditim. Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

### **Kriteret e vlerësimit**

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

<b>Lloji i dokumentit</b>	<b>Detajet e bazës ligjore dhe rregullatorë</b>
<b>Standarde auditimi dhe kuadri ligjor i KLSH:</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Ligji nr.154/2014 òPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Rregullore e Brendshme òMbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-sëò, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.85, datë 30.06.2015, i ndryshuar; Rregullore òMbi Procedurat e auditimit në KLSHò, miratuar me Vendimin nr. 63, datë 22.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar.
<b>Ligje:</b>	Ligji nr. 10352, datë 18.11.2010 òPër Artin dhe Kulturënò Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 òPër arkivatò Kodi i Procedurës Civile i RSH Kodi Civil i RSH



	Kodi i Punës i RSH Ligji nr. 10018/2008 òPër Avokaturën EHò
<b>Vendime të Këshillimit të Ministrave (VKM)</b>	VKM nr. 173, datë 07.03.2003 òPër emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të Drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Ministritò; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 òPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò; VKM nr. 117, datë 5.03.2014 òPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit.
<b>Akte të tjera nën ligjore:</b>	Rregullore e Brendshme e Ministrisë së Kulturës, miratuar me Urdhrin nr. 348, datë 18.09.2015; Statuti i Cirkut Kombëtar; Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Cirkut Kombëtar; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 i Ministrit të Financave òPër menaxhimin e aktiveveò; Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

## **6. Standardet e auditimit të aplikuara në krverjen e punës.**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

## **7. Metodatat e auditimit**

Metodat dhe teknikat e përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon:

(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

**1. Kontroll aritmetik** që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

**2. Inspektim fizik** dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

**3. Kontrolli i vlerësimit** për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**4. Verifikimi i transaksioneve** duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.

**5. Intervistimi i personelit** që ka patur role specifike në subjektin që u auditua.

**6. Raporte dhe informacione** nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

**7. Pyetësorë** për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

### **8. Dokumentimi i auditimit**

Gjatë ushtrimit të auditimit tematik, objektivi i auditimit është përqendrimi i auditimit në çështje, problematika, tematika, apo sektorë specifikë, dhënia e opinionit nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti i subjektit të audituar është në përputhje ose jo me dispozitat dhe rregulloret përkatëse.

Vlerësimi i riskut, në auditimet e tematike (përputhshmërisë), është një parashikim i arsyeshëm, lidhur me nivelin e mundshëm të shmangieve përse i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke patur parasysh tre komponentët e riskut të auditimit:

**Risku i brendshëm**, i shmangies nga përputhshmëria apo gabimeve, vlerësohet të jetë i mesëm për shkak të:

Kompleksitetit të kuadrit rregullator dhe kohës në të cilën është miratuar kjo bazë ligjore.

Ndryshimet e shpeshta të strukturës organizative.

**Risku i kontrollit** është risku që një shmangie materiale (e rëndësishme) mund të ndodhë dhe që nuk parandalohet, zbulohet dhe korrigjohet në kohën e duhur, nga sistemet e kontrollit të brendshëm. Risku i kontrollit vlerësohet i mesëm duke qenë se ekzistojnë procedura të kontrollit me anë të konfirmimeve nga palë të treta gjatë zhvillimit të procedurës.

**Risku i moszbulimit** është risku që auditimi të mos zbulojë shmangie materiale të ndodhura dhe që nuk janë parandaluar apo zbuluar dhe korrigjuar në kohën e duhur nga sistemi i kontrollit të brendshëm të njësisë, entit, departamentit, agjencisë, organizatës, institucionit, etj. Risku i moszbulimit do të jetë i ulët duke marrë parasysh nivelin e pranuar të riskut dhe riskun e vlerësuar të brendshëm dhe atë të kontrollit.<sup>1</sup>

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, observacioneve të paraqitura nga subjekti mbi akt-konstatimet e lëna në subjekt, dhe takimit përmbysllës mbas fazës së përfundimit në terren midis niveleve drejtuese, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

## **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

### **III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Cirku Kombëtar është person juridik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit të Kulturës. Cirku Kombëtar ka objekt të veprimtarisë së tij, mbështetjen në vlerat e kulturës dhe artit kombëtar, si dhe në vlerat më të mira të kulturës dhe artit botëror. Cirku Kombëtar

---

<sup>1</sup> Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, Kapitulli 4.3.2 - Për të ruajtur nivelin e riskut të auditimit (deri 5 %) të përcaktuar në politikat audituese të KLSH-së, sa më i lartë të vlerësohet nga audituesit niveli i riskut të brendshëm dhe/ose të kontrollit, aq më i ulët duhet të jetë risku i mos zbulimit.

organizohet dhe funksionin në zbatim të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 òPër Artin dhe Kulturën.

Cirku Kombëtar është pronë shtetërore, regjimi juridik i të cilit rregullohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 òPër pronat e paluajtshme shtetërore, i ndryshuar. Në vitin 2011, Këshilli i Ministrave, me anë të VKM-së nr. 458, datë 22.06.2011 òPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të pronës nr. 276, òCirku i Tiranës, ka kaluar Cirkun Kombëtar në juridiksion të Bashkisë së Tiranës.

Cirku Kombëtar funksionet:

- a) Cirku Kombëtar zbaton e politikat shtetërore dhe kombëtare në fushën e artit. Ai ka për mision ruajtjen dhe lartësimin e identitetit kombëtar duke nxitur krijimin dhe interpretimin e veprave cilësore, nëpërmjet profileve të akrobacisë, ekuilibrit, ajrit, dresimit, zhonglimit, kllounatës, iluzionimit si dhe nëndarjet e tyre;
- b) Cirku Kombëtar ka si objekt të veprimtarisë së tij zhvillimin e artit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, realizimin e veprave të reja në profilet e Cirkut, si dhe promovimin e këtyre veprave dhe vlerave, brenda dhe jashtë vendit;
- c) Cirku Kombëtar ka për detyrë përsosjen e mjeteve shprehëse të interpretimit, bashkëpunimin dhe inkurajimin e iniciativave frytdhënëse që ndihmojnë në realizimin e synimeve të tij;
- d) Ai realizon ristrukturimin e sektorëve të veçantë, përsosjen e mjeteve të punës, të rekuizitës e të gardërobës së shfaqjes, kualifikimin profesional të punonjësve të tij, si dhe inkurajimin e iniciativave dobiprurëse dhe eksperimentimin profesional.

Nga sa më sipër, Cirku Kombëtar është institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës. Ministria e Kulturës në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

ó Harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë .

ó Harton dhe bashkërendon punën për politikat në fushën e artit e të kulturës nëpërmjet edukimit të popullsisë, ri jetësimit të vlerave dhe trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal.

ó Harton politikat, mbrojtëse dhe promovuese, për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve.

ó Harton politika për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse.

ó Udhëheq, programon dhe mbështet veprimtaritë, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike dhe letrare, brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore dhe për krijimin e një hapësire dialogu mbarë shqiptar dhe të diversitetit kulturor.

ó Nëpërmjet strukturave të varësisë realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore. ó Kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin.

Për rrjedhojë, mbështetur në objektivat e këtij auditimi, me qëllim vlerësimin e çështjeve të evidentuara dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes së konstatuar nga grupi i auditimit, ky auditim u shtri në subjektet nën auditim: Ministra e Kulturës dhe Cirku Kombëtar.

## **III.2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT**

### **III.2.1 Procedurat e ndjekura për tjetërsimin e pronës, ku ushtrohej më parë aktiviteti i Cirkut të Tiranës (finalizuar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 8473, datë 17.12.2019) në Ministrinë e Kulturës.**

Cirku Kombëtar është një pronë shtetërore regjimi i të cilit rregullohet me Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 *óPër pronat e paluajtshmeó*, ku në nenin 3 pika 3 parashikohet që: *“... i përkasin shtetit dhe bëjnë pjesë në pronat e paluajtshme publike, parqet, lulishtet, sheshet publike në qendrat e banuara, ndërtesat së bashku me oborret që përdoren për ofrimin e shërbimeve që ofrohen nga shteti për arsimin, shkencën, kulturën dhe sportet.”*

Cirku Kombëtar është person juridik në varësi të Ministrisë së Kulturës, në zbatim të VKM-së nr. 458, datë 22.06.2011 *óPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të pronës nr.276 óCirku i Tiranësó në juridiksion të Bashkisë së Tiranësó*

Më datën 12.12.2011 z. A.V. pala shitëse dhe Shoqëria óUó pala blerëse, kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes me nr. 8034 Rep., nr. 2277 Kol., për sipërfaqen e truallit 1073 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 6/343, Zona Kadastrale 8350, e ndodhur në Tiranë.

Më datë 10.10.2018 Shoqëria óUó shpk, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi, ku është kërkuar palës paditëse Cirkut Kombëtar të ndërpres posedimin e paligjshëm mbi truallin e sipërcituar. Gjithashtu, është kërkuar që pala e paditur të shpërblejë dëmin pasuror nga data 12.12.2011 deri në datën e administrimit të akt-ekspertimit.

Cirku Kombëtar ka marrë dijeni për procesin gjyqësor nëpërmjet fletëthirrjes nr. 13726, datë 30.10.2018 (protokolluar në Cirkun Kombëtar me nr. 395, datë 09.11.2018).

Me shkresën nr. 396, datë 09.11.2018 Cirku Kombëtar i është drejtuar Ministrisë së Kulturës, duke i kërkuar asistencë për përfaqësimin ligjor, për shkak se Cirku Kombëtar nuk kishte jurist në strukturën institucionale dhe i ka përcjell të gjithë praktikën në lidhje me kërkesëpadinë.

Drejtori i Cirkut Kombëtar, z. S.Ç., me shkresën nr. 421, datë 04.12.2018 ka autorizuar znj. M.M. dhe/ose z. D.Z., Jurist në Ministrinë e Kulturës, të përfaqësojnë Cirkun Kombëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me këtë proces gjyqësor.

Me shkresën nr. 42/1, datë 07.12.2018 Cirku Kombëtar, nëpërmjet përfaqësues së tij znj. M.M. ka depozituar në gjykatë deklaratën e mbrojtjes në lidhje me këtë proces gjyqësor.

Ministria e Kulturës, me shkresën nr. 1474, datë 05.03.2019, ka autorizuar znj. J.S., juriste pranë Ministrisë së Kulturës, për të përfaqësuar Cirkun Kombëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me këtë proces gjyqësor.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtar A.ZH. ka filluar shqyrtimin gjyqësor në lidhje me kërkesëpadinë e Shoqërisë òUò shpk.

**Nga shqyrtimi i fashikullit të gjykimit rezulton se janë zhvilluar 15 seanca gjyqësore dhe vetëm për 2 prej tyre rezulton të ketë memo informuese nga ana e juristes së Ministrisë së Kulturës znj. J.S.. Në lidhje me seancat e tjera të zhvilluara nuk rezulton të ketë asnjë informacion se çfarë ka ndodhur gjatë shqyrtimit gjyqësor në këto seanca. Po kështu, rezulton që gjykata të ketë shtyrë seancat gjyqësore për shkak të mungesës së përfaqësueses së palë së paditur.**

Nëpërmjet memos së protokolluar me nr. 1905, datë 20.03.2019, përfaqësuesja e Ministrisë së Kulturës znj. J.S. ka raportuar te eprorët në lidhje me seancën gjyqësore të datës 07.03.2019, ku Gjykata i përcaktoi detyrat ekspertit të caktuar nga Gjykata në seancën e mëparshme. **Në këtë memo nuk është raportuar qëndrimi i përfaqësuesit në lidhje me seancën gjyqësore dhe për kërkesat e palëve.**

Nëpërmjet memos së protokolluar me nr. 1905/1, datë 08.04.2019, përfaqësuesja e Ministrisë së Kulturës znj. J.S. ka raportuar te eprorët, në lidhje me seancën gjyqësore të datës 07.03.2019 (lapsus i Znj. S. pasi bëhet fjalë për seancën e datës 03.04.2019), **pa u shprehur mbi qëndrimin e saj në lidhje me këtë seancë.**

Në datën 27.05.2019 është dorëzuar në gjykatë akti-ekspertimit të ing. E. D. L.

Me datë 25.06.2019 pala paditëse ka kërkuar saktësim të objektit të kërkesëpadiisë, duke përcaktuar edhe si vlerë të dëmshpërblimit, vlerën e përcaktuar në aktin e ekspertimit.

Me shkresën nr. 1474/, datë 23.09.2019, juristja e autorizuar, J.S. ka depozituar prapësimet në lidhje me këtë proces gjyqësor.

Referuar fashikullit të gjykimit nuk rezulton të jetë thirrur si palë në këtë proces Avokatura e Shtetit, sipas përcaktimeve të neneve 130 dhe 131 të Kodit të Procedurës Civile.

**Referuar përmbajtjes së prapësimeve konstatohet se në asnjë moment nuk janë ngritur pretendime në lidhje me mos thirrjen e Avokaturës së Shtetit në këtë proces gjyqësor, si subjekt i interesuar, bazuar në përcaktimet e neni nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile dhe neni 5 të Ligjit nr. 10018/2008 “Për avokaturën e shtetit”.**

Po kështu në asnjë moment nuk rezulton të jenë ngritur pretendime në lidhje me afatet e parashkrimit të kërkesëpadiisë për dëmshpërblim, e cila referuar rastit konkretë është kërkim për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe është 3 vjet. Në kushtet kur pala paditëse është vënë në dijeni në momentin e kryerjes së transaksionit në vitin 2011 dhe padia është paraqitur në 2019 rezulton se kanë kaluar 8 vjet.

Po kështu nuk rezulton të jetë kontestuar pretendimi në lidhje me dëmin e shkaktuar, qëndrim të cilin e ka mbajtur edhe Avokatura e Shtetit në ankimin e paraqitur në gjykatë së bashku me kërkesën për rivendosje në afat të të drejtës së ankimit.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. 8473, datë 17.12.2019, ka vendosur pranimin e padisë duke detyruar palën e paditur të ndërpres posedimin e paligjshëm mbi truallin me sipërfaqe 1073 m<sup>2</sup>, nr. Pasurie 6/282, Zona Kadastrale 8350, në pronësi të paditësit shoqëria òUò shpk dhe dëmshpërblimin e palës paditëse në vlerën 31.443.757, duke përfshirë edhe vlerën ditore të përdorimit të përcaktuar nga ekspertja duke filluar nga data 28.05.2019 deri në datën e dorëzimit të tij.

Në përmjet fletëthirrjes me nr. akti. 3322, datë 05.12.2019, protokolluar në Cirkun Kombëtar me nr. 660, datë 10.12.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka njoftuar në lidhje me zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 12.12.2019.

Sipas përmbajtjes së aktit evidentohet që personi që e ka marrë në dorëzim është z. L.H., dhe nuk ka informacion se çfarë është bërë me njoftimin.

**Në shpalljen e vendimit, rezultoi se nuk ka qenë prezent përfaqësuesit e palës së paditur Cirkut Kombëtar.**

**Juristët e autorizuar për të përfaqësuar Cirkun Kombëtar, në zbatim të nenit 46 të Rregullores së Brendshme të Ministrisë së Kulturës, miratuar me Urdhrin nr. 348, datë 18.09.2015 kanë patur detyrimin që të informonin në mënyrë të vazhdueshme dhe të merrnin informacion në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, pavarësisht se ky vendim do ti përcillej Cirkut Kombëtar, në kushtet kur përfaqësuesit kanë qenë në mungesë.**

Z. D.Z. ka qenë specialist në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore për periudhën 16 Shkurt 2018 deri më 07 Mars 2019.

Znj. M.M., specialiste në Sektorin e Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, është emëruar në këtë pozicion pune më datë 23.07.2018 dhe është liruar nga kjo detyrë më datën 12.09.2021.

Gjithashtu, në memon me nr. 44 prot, datë 07.01.2021 në kuadër të ndjekjes së proceseve gjyqësore në të treja shkallët e gjykimit, në lidhje me këtë proces gjyqësor, në faqen 3 të materialit është evidentuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor në lidhje me procesin gjyqësor me palë paditëse z. A.V. dhe të paditur Cirkut Kombëtar, me objekt pagim shume, gjyqtari i seancës ka konstatuar se midis juristes së Ministrisë së Kulturës dhe përfaqësuesit ligjor që ndjek çështjen civile të Z. A.V. ka lidhje familjare.

Ky fakt i evidentuar kompromenton efektivitetin në mbrojtje nga ana e përfaqësueses së Cirkut Kombëtar Znj. J.S. dhe ngre dyshime mbi mbrojtjen ligjore të procesit që lidhet me Vendimin nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në lidhje me shkeljet e evidentuara më sipër mbajnë përgjegjësi juristët e autorizuar për ndjekjen e procesit gjyqësor, znj. J.S., z. D.Z., znj. M.M. dhe Drejtori i Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, znj. O.C., në cilësinë e eprorit.

Ky vendimi është përcjell Cirkut Kombëtar për dijeni dhe është protokolluar në institucion me nr. 26, datë 17.01.2020 dhe **duhet të ishte ankimuar brenda 03.02.2020**, sipas parashikimeve të nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile.

**Ky vendim ka marr formë të prerë më datë 11.02.2020 pasi nuk është ankimuar deri më datën 03.02.2020.**

Në kushtet kur vendimi gjyqësor ka marr formë të prerë, Cirkun Kombëtar duhet të kishte ekzekutuar në mënyrë vullnetare detyrimet që lidhen me zbatimin e Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me qëllim shmangien e tarifave përmbartimore.

Tarifat fikse të shërbimit përmbartimor për ekzekutimin e shumës në vlerën 1,911,035 (një milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e pesë) lekë, me TVSH dhe tarifa përmbartimore për lirim dhe vënien në posedim të pasurisë së paluajtshme në vlerën 8,629,200 (tetë milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind) lekë me TVSH, konsiderohen si përdorim pa efektivitet të fondeve publike

Më datë 25.06.2020 zyra përmbartimore òK.B.S.ò shpk i ka dërguar palës debitore, Cirkut Kombëtar, një shkresë nëpërmjet të cilën e lajmëron për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, sipas Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas kësaj shkrese, Drejtori i Cirkut, z. I.GJ., nëpërmjet shkresës nr. prot. 176, datë 01.07.2021 i ka kërkuar z. E.M., përmbartues gjyqësor, ta sqaroj se kujt titulli ekzekutiv (Vendimi Gjykate) i përket ky detyrim, kur në fakt referuar përmbajtjes së saj evidentohet qartësisht se i përket Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Rezulton se ka kaluar afërisht 1 vit që nga njoftimi për ekzekutim vullnetar të detyrimit dhe nga ana e Cirkut Kombëtar nuk është ndërmarr asnjë veprim ligjor në lidhje me këtë shkresë të përmbartuesit gjyqësor, e cila ka sjell pasojë detyrimin për të paguar vlerën 7,903,272 (shtatëmilion e nëntëqind e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, përcaktuar në urdhrin e vendosjes së masës së sekuestros konservative.

Në vijimësi, më datë 08.07.2021, përmbartuesi gjyqësor i zyrës përmbartimore òK.B.S.ò shpk, ka sqaruar Cirkun Kombëtar lidhur me kërkesën e parashtruar prej tyre, duke i bashkëlidhur edhe një kopje të vendimit gjyqësor.

Pas kalimit të afateve ligjore, ndodhur në kushtet që nga ana e palës debitore nuk janë marrë masa për shlyerjen e detyrimit, më datë 12.07.2021, nëpërmjet shkresës nr. prot. 454/7-0025-21 i është drejtuar Bankave të Nivelit të II-të në Republikën e Shqipërisë me Urdhër òPër Vënien e Sekuestros Konservativë.

Po në të njëjtën datë, zyra përmbartimore òK.B.S.ò shpk ka marrë vendimin për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të Urdhrit të ekzekutimit të Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas këtyre veprimeve procedurale, zyra përmbartimore i ka dërguar një kopje të vendimit dhe korrespondencës me Cirkun edhe Bashkisë së Tiranës, nëpërmjet shkresës nr. prot. 454/8-0025-21, datë 13.07.2021, duke i kërkuar Bashkisë Tiranë dhe Cirkut Kombëtar kryerjen e likuidimit të

detyrimet financiar, në zbatim të titullit të ekzekutimit, shkresë të cilën ja ka përcjellë për dijëni edhe Ministrisë së Kulturës.

Pas këtij fakti, më datë 15.07.2021, nëpërmjet shkresës nr. prot. 184, Drejtori i Cirkut Kombëtar z. I.G.J., i ka dërguar znj. E.C., Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, korrespondencën ndërmjet Cirkut Kombëtar dhe zyrës përbarimore òK.B.S.ò shpk në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Rezulton se kjo korrespondencë është përcjell në Ministrinë e Kulturës pa u protokolluar më parë në institucionin e Cirkut Kombëtar.

Më datë 13.08.2021, Ministria e Kulturës, nëpërmjet shkresës nr. prot. 4053/2 i ka kthyer përgjigje zyrës së përbarimit, duke vënë në dijëni edhe Degën e Thesarit Tiranë, lidhur me qëndrimin institucional të saj përsa i përket ekzekutimit të vendimit.

Në lidhje me këtë fakt, Ministria e Kulturës ka mbajtur qëndrim si më poshtë vijon:

- Ministria e Kulturës ka paraqitur kundërshtim të veprimeve përbarimore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nëpërmjet shkresës nr. prot. 3672/1, datë 27.07.2021 dhe me shkresën nr. prot. 3672/2, datë 28.07.2021 ka paraqitur kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës për të ushtruar ankim ndaj Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke theksuar faktin se MK nuk ka qenë palë ndërgjyqëse në këtë proces; si dhe
- Në zbatim të ligjit nr. 137/2020 òPër buxhetin e vitit 2021ò, si dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, Ministria e Kulturës nuk disponon fonde për ekzekutimin e titullit ekzekutiv të vendimit.
- Më datë 18.08.2021, nëpërmjet shkresës nr. prot. 454/24-0025-21 òKthim Përgjigjeò, përbaruesi gjyqësor i zyrës përbarimore òK.B.S.ò shpk, z. E.M. ka informuar Ministrinë e Kulturës se nëpërmjet Vendimit nr. 5548, datë 04.08.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur kthimin e akteve të çështjes civile me nr. 14362 akt., datë regj. 29.07.2021 që i përket palës paditëse Ministrisë së Kulturës, duke i dërguar një kopje të këtij vendimi Ministrisë.

Këtë korrespondencë, z. M. ja ka vënë në dijëni edhe Bashkisë Tiranë dhe Kryeministrisë.

Pas këtij veprimi, më datë 27.08.2021, zyra përbarimore ka caktuar ekspert për çmontimin e çadrës, Vendim të cilin ja ka përcjellë për dijëni edhe Cirkut Kombëtar, Shoqërisë òUò shpk dhe Ministrisë së Kulturës, nëpërmjet shkresës me nr. prot. 454/31-0025-21.

Më datë 33.08.2021 Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Dega Tiranë, ka nxjerrë urdhër të brendshëm për vënien e sekuestros konservative me nr. prot. 4838/14, për të bllokuar fondet buxhetore të Institucionit debitor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të pasqyruara në Urdhrin e Përbaruesit Gjyqësor nr. prot. 454/23, datë 16.08.2021, në favor të palës kreditore shoqëria òUò shpk.

Ndodhur në këto rrethana, Ministria e Kulturës më datë 07.09.2021, nëpërmjet shkresës nr. prot.4551/1, ka ankimuar Vendimin nr. 5548, datë 04.08.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilin ja ka vënë në dijëni edhe Avokaturës së Shtetit.

Për sa më sipër, më datë 10.09.2021, Avokatura e Shtetit i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Kulturës nëpërmjet shkresës nr. prot. 3237/6, duke u shprehur se është vënë në dijëni lidhur me Vendimin nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë ndërgjyqëse: paditës: Shoqëria òUò shpk dhe palë e paditur: òCirkut Kombëtarò, nëpërmjet shkresës së dërguar nga ana e Ministrisë së Kulturës, datë 26.07.2021, pasi nuk ka qenë e informuar nga gjykata apo nga pala e paditur lidhur me këtë proces.



Po më datë 10.09.2021, Avokatura e Shtetit, në sinkron me qëndrimin e përcjellë në MK, i ka dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesën për rivendosjen në afat nëpërmjet shkresës nr. prot. 3237/3 për të ushtruar të drejtën e ankimit ndaj Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019.

Me shkresën nr. 1129/16, datë 06.05.2022 Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar informacion lidhur me statusin e gjykimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në përgjigje të kërkesës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vërtetimin e datës 16.05.2022 ka bërë me dije vendimin në lidhje me pranimin e kërkesës për rivendosjen e Avokaturës së Shtetit në afat për t'iu drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë.

Më datë 16.09.2021, nëpërmjet shkresës nr. prot. 6121/2, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka kthyer përgjigje shkresës nr. prot. 4053/4, datë 26.08.2021 të MK-së, duke i vënë në dispozicion kopjen origjinale të Vendimit nr. 5548 datë 04.08.2021, me anë të të cilit është vendosur: òkthimi i akteveí ..ò, si dhe dëftesën e komunikimit me anë të së cilës është realizuar njoftimi.

Me shkresën nr. prot. 4339/1, datë 17.09.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, znj. E.Ç., i ka kthyer përgjigje Degës së Thesarit Tiranë, duke i bërë me dije likuidimin e detyrimeve gjyqësore që Ministria ka ndaj të tretëve.

Më datë 22.09.2021, Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit, Dega Tiranë, nëpërmjet shkresës me nr. prot. 4838/17, i është drejtuar Ministrisë së Kulturës, pasi është njohur me përmbajtjen e kërkesës së ministrisë së sipërcituar, i ka bërë me dije Ministrisë së Kulturës se nuk mund të ndërpresë procedurën e ekzekutimit dhe e ka orientuar Ministrinë që të shfrytëzoj hapësirat ligjore duke iu drejtuar gjykatës përkatëse për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore.

Me shkresën nr. prot. 4914/1, datë 01.10.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, znj. E.Ç., i ka kthyer përgjigje zyrës përmbartimore òK.B.S.ò shpk, në vijim të shkresës së dërguar prej tyre, duke i bërë me dije se: *“nga Avokatura e Shtetit, MK është informuar se ka ushtruar të drejtën ligjore të kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës për të ushtruar ankim. Ndodhur në këto kushte, për aq kohë sa ende nuk ka një vendim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe Gjykata e Apelit Tiranë, për mospranimin e ankesës dhe ankimit të cituar, nuk mund të vijohet me çmontimin/demolimin e ndërtesës së Cirkut Kombëtar.”*

Më datë 05.10.2021 Zyra Përmbartimore òK.B.S.ò shpk. në referim të titullit ekzekutiv i është drejtuar me shkresë nr. prot. 553/9-0025-21 i është drejtuar Komisarariatit nr. 3 të Policisë Tiranë, Njësisë Administrative nr. 9, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Inspektoriatit për Mbrojtjen e Territorit, Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Vendor Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin, Furnizuesit të Shërbimit Universal, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, Qendrës Kombëtare të Urgjencave Mjekësore, Cirkut Kombëtar, Ministrisë së Kulturës, Kryeministrisë dhe Shoqërisë òUò shpk., duke kërkuar mbështetje për lirim dhe vënien në posedim të sendit të paluajtshëm: *“.....sendin, truall me sipërfaqe 1073m2, me nr. pasurie 6/282, zona kadastrale 8350, në pronësi të palës kreditore shoqëria “U” shpk., në datën 20.10.2021 në ora 11:00.”*

Më datë 06.10.2021 zyra përmbartimore òK.B.S.ò shpk. i është drejtuar sërish disa nga institucioneve të lartpërmendura, duke i kërkuar të ndërpritet furnizimi me energji elektrike dhe furnizimi me ujë të pijshëm, përpara datës 20.10.2021 ora 11:00, deri në një njoftim të dytë.

**Nga sa më sipër, rezulton se Drejtori i Cirkut Kombëtar nuk ka ndërmarr asnjë masë në lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve që lidhen me Vendimin nr. 8473, datë 17.12.2019. Në asnjë moment nuk është ngritur një grup pune me qëllim marrjen masave për ndjekjen e kësaj procedure.**

Më datë 12.10.2021 Ministria e Kulturës i ka dërguar një kërkesë Gjykatës së Apelit për të pezulluar ekzekutimin e Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019.

Në lidhje me mungesën e ankimimit të vendimit nr. 8473 prot, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Drejtori i Cirkut Kombëtar ka dhënë masën disiplinore ÷Vërejtje, për specialisten znj. M.D.. Kjo masë disiplinore është bazuar në procesverbalin nr. 190, datë 26.07.2021.

Referuar përmbajtjes, është evidentuar mbledhja e zhvilluar me prezencë të Drejtorit të Institucionit, z. I.GJ., Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse znj. S.B., Drejtuesi Artistik znj. A.H., Përgjegjësi i Sektorit Teknik z. L.H. dhe Specialistes znj. M.D..

Sipas përmbajtjes së këtij procesverbali në këtë mbledhje është shqyrtuar vendimi i ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 8473 prot, datë 17.12.2019, protokolluar në Cirkun Kombëtar me nr. 26 prot., datë 17.01.2020, e cila nuk është përcjell në Ministrinë e Kulturës. Ky veprim u cilësua si gabim njerëzor dhe specialistja znj. M.D. pranoi gabimin e kryer.

Përveç Drejtorit të Cirkut Kombëtar z. I.GJ. dhe Përgjegjësit të Sektorit Teknik z. L.H., të gjithë personat e tjerë që kanë nënshkruar, kanë shprehur se nuk kanë qenë dakort me përmbajtjen dhe procedurën.

Referuar kësaj procedure konstatohet se është në shkelje të përcaktimeve të Kodit të Punës dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Sipas deklaratës së znj. M.D., protokolluar në Ministrinë e Kulturës me shkresën nr. 4037, datë 30.07.2021 rezulton se nga kronologjia e shkresave është një proces fiktiv. Kjo pasi vendimi i për masën disiplinore është përpiluar dhe protokolluar përpara procesverbalit. Ndërkohë sipas përmbajtjes së vendimit evidentohet që vendimmarrja bazohet në konstatimet e procesverbalit të mbajtur.

Me Urdhrin nr. 495, datë 27.07.2021 të Ministrit të Kulturës, është ngritur grupi i punës për hetimin administrativ lidhur me mos përcjelljen në Ministrinë e Kulturës të Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në përbërje të grupit ka qenë znj. E.D., Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, znj. H.D., Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjisë së Zhvillimit të Kulturës, znj. O.C., Drejtor i Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve, z. L.T., Specialist në Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve, z. L.P., Specialist në Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve.

Grupi i punës pas hetimit administrativ të zhvilluar, nëpërmjet memos nr. 3936/5, datë 29.07.2021 i ka përcjell Ministrit të Kulturës, konkluzionet në lidhje me to, duke i sugjeruar edhe fillimin e procedimit disiplinor për Drejtorin e Cirkut Kombëtar, në lidhje me shkeljet e evidentuara, ndër të

cilat ishte dhe mosveprimi në lidhje me përcjelljen e vendimit të gjykatës në Ministrinë e Kulturës.

Me shkresën nr. 4065, datë 30.07.2021 është njoftuar Drejtori i Cirkut Kombëtar për fillimin e procedimit disiplinor.

Me shkresën nr. 4065/6, datë 17.08.2021 të Ministrisë së Kulturës është përcjell për njohje Vendimi nr. 4065/5, datë 17.08.2021, për dhënien e masës disiplinor ÷Vërejtje me paralajmërim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për Drejtorin e Cirkut Kombëtar, z. I.GJ..

Referuar shkeljeve të evidentuara në procedimin administrativ të zhvilluar janë konstatuar shkelje të rënda të detyrave funksionale të cilat kanë pasjellë pasoja të rënda për institucionin. Në këto kushte Ministri i Kulturës, duhet të kishte filluar procedurën për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Përcaktimi i masës disiplinore ÷vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra, nuk është proporcionale në raport me shkeljet e evidentuara.

**Mosveprimet e Drejtorit të Cirkut Kombëtar në lidhje me mungesën e ankimimit të vendimit gjyqësor dhe mos përcjelljes së tij në Ministrinë e Kulturës, janë në shkelje të Ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, neni 8 dhe 9, Statutin e Cirkut Kombëtar, neni 7, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Cirkut Kombëtar, neni 5, Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 17.**

Për sa më lart, bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, u arrit në gjetjet e auditimit si më poshtë vijon:

<b>Titulli i gjetjes</b>	Mangësi në procedurat e ndjekura për tjetërsimin e pronës, ku ushtrohej më parë aktiviteti i Cirkut të Tiranës (finalizuar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 8473, datë 17.12.2019) në Ministrinë e Kulturës
<b>Situata:</b>	<p>Nga shqyrtimi i fashikullit të gjykimit rezulton se janë zhvilluar 15 seanca gjyqësore dhe vetëm për 2 prej tyre rezulton të ketë memo informuese nga ana e juristes së Ministrisë së Kulturës znj. J.S.. Në lidhje me seancat e tjera të zhvilluara nuk rezulton të ketë asnjë informacion se çfarë ka ndodhur gjatë shqyrtimit gjyqësor në këto seanca. Po kështu, rezulton që gjykata të ketë shtyrë seancat gjyqësore për shkak të mungesës së përfaqësueses së palë së paditur.</p> <p>Referuar përmbajtjes së prapësimeve konstatohet se në asnjë moment, nga përfaqësuesi ligjor i Cirkut Kombëtar nuk janë ngritur pretendime në lidhje me mos thirrjen e Avokaturës së Shtetit në këtë proces gjyqësor, si subjekt i interesuar, bazuar në përcaktimet e neni nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 5 të Ligjit nr. 10018/2008 ÷Për avokaturën e shtetit.</p> <p>Referuar qëndrimeve të përfaqësueses së Cirkut Kombëtar znj. J.S., në kushtet kur pretendimi i tyre ka qenë për një posedim të ligjshëm për afërsisht 50 vjet, nuk është ngritur asnjëherë pretendimi, nëpërmjet një kundërpadie në lidhje me ekzistencën e kushteve të fitimit të pronësisë nga Cirkut Kombëtar për truallin objekt gjykimi, nëpërmjet parashkrimit fitues.</p>

Nuk rezulton të jenë ngritur pretendime në lidhje me afatet e parashkrimit të kërkesëpadisë për dëmshpërblim, e cila referuar rastit konkretë është kërkim për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe është 3 vjet. Në kushtet kur pala paditëse është vënë në dijeni në momentin e kryerjes së transaksionit në vitin 2011 dhe padia është paraqitur në 2019 rezulton se kanë kaluar 8 vjet.

Nuk rezulton të jetë kontestuar pretendimi në lidhje me dëmin e shkaktuar, qëndrim të cilin e ka mbajtur edhe Avokatura e Shtetit në ankimin e paraqitur në gjykatë së bashku me kërkesën për rivendosje në afat të të drejtës së ankimit.

Në shpalljen e vendimit, rezultoi se nuk ka qenë prezent përfaqësuesit e palës së paditur Cirkut Kombëtar. Ky vendim ka marr formë të prerë më datë 11.02.2020 pasi nuk është ankimuar deri më datën 03.02.2020. Në kushtet kur vendimi gjyqësor ka marr formë të prerë, Cirkut Kombëtar duhet të kishte ekzekutuar në mënyrë vullnetare detyrimet që lidhen me zbatimin e Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me qëllim shmangien e tarifave përmbartimore.

Tarifat fikse të shërbimit përmbartimor për ekzekutimin e shumës në vlerën 1,911,035 (një milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e pesë) lekë, me TVSH dhe tarifa përmbartimore për lirim dhe vënien në posedim të pasurisë së paluajtshme në vlerën 8,629,200 (tetë milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind) lekë me TVSH, konsiderohen përdorim pa efektivitet të fondeve publike.

Rezulton se ka kaluar afërisht 1 vit që nga njoftimi për ekzekutim vullnetar të detyrimit dhe nga ana e Cirkut Kombëtar nuk është ndërmarr asnjë veprim ligjor në lidhje me këtë shkresë të përmbartuesit gjyqësor, e cila ka sjell pasoja shumë të rënda për institucionin dhe njëkohësisht për buxhetin e shtetit. Detyrimi i përcaktuar në urdhrin e vendosjes së masës së sekuestros konservative, që lidhet me vlerën e përdorimit të pronës për periudhën 28.05.2019-28.05.2021, në masën 7,903,272 (shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, konsiderohet si dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Në lidhje me procesin gjyqësor me palë paditëse z. A.V. dhe të paditur Cirkut Kombëtar, me objekt pagim shume, gjyqtari i seancës ka konstatuar se midis juristes së Ministrisë së Kulturës dhe përfaqësuesit ligjor që ndjek çështjen civile të Z. A.V. ka lidhje familjare. Ky fakt i rëndë i evidentuar kompromenton efektivitetin në mbrojtje nga ana e përfaqësueses së Cirkut Kombëtar Znj. J.S. dhe ngre dyshime mbi mbrojtjen ligjore të procesit që lidhet me Vendimin nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Drejtori i Cirkut Kombëtar nuk ka ndërmarr asnjë masë në lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve që lidhen me Vendimin nr. 8473, datë 17.12.2019. Në asnjë moment nuk është ngritur një grup pune me qëllim marrjen masave për ndjekje e këtij procesi.

	Përcaktimi i masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, nga ana e MK-së për Drejtorin e Cirkut Kombëtar, z. I.GJ., nuk është proporcionale në raport me shkeljet e evidentuara.
<b>Kriteri:</b>	<p>-Kodit të Procedurës Civile, neni 35, 79/a, 130 dhe 131;</p> <p>-Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;</p> <p>-Ligji nr. 10018/2008 “Për avokaturën e shtetit”, neni 5;</p> <p>-Rregullore e Brendshme e Ministrisë së Kulturës, miratuar me Urdhrin nr. 348, datë 18.09.2015 neni 46;</p> <p>-Ligji nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, neni 8 dhe 9;</p> <p>-Statuti i Cirkut Kombëtar, neni 7;</p> <p>-Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Cirkut Kombëtar, neni 5;</p> <p>-Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; dhe</p> <p>-Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 17.</p>
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	<p>Faktet e evidentuara komprometojnë efektivitetin në mbrojtje nga ana e përfaqësueses së Cirkut Kombëtar dhe ngrenë dyshime mbi mbrojtjen ligjore të procesit që lidhet me Vendimin nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.</p> <p>Mos veprimet dhe neglizhenca e konstatuara kanë sjelle si pasojë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën <b>7,903,272 (shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë</b> me TVSH.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi për mbrojtje efektive gjatë proceseve gjyqësore;</p> <p>Pranimi i kërkesëpadisë dhe rrëzimi i pretendime të juristëve që përfaqësonin në këtë proces Cirkun Kombëtar.</p> <p>Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.</p>
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Ministria e Kulturës dhe Cirku Kombëtar të marrin masa që përfaqësuesit ligjor të institucionit të jenë prezent në ndjekjen e çdo seancë gjyqësore në proceset në ndjekje.</p> <p>Ministria e Kulturës dhe Cirku Kombëtar të marrin masa që qëndrimet në lidhje me proceset gjyqësore, ti nënshtrohen shqyrtimit të hallkave institucionale përgjegjëse para se të dërgohen në gjykatë, me qëllim që përfaqësimi ligjor të jetë sa më i plotë dhe efektiv.</p> <p>Cirku Kombëtar të hartoj një metodologji për procedurën e dërgimit të praktikave protokollare te titullari i institucionit dhe kalimin e këtyre praktikave te strukturat përgjegjëse, me qëllim dokumentimin e procesit dhe përcaktimin e përgjegjësive.</p>

	<p>Të ndiqen procedurat ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore për shkeljet e evidentuara për znj. J.S., Znj. M.M. dhe znj. O.C., sipas shkallës së përgjegjësisë.</p> <p>Ministria e Kulturës të filloj procedurat ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për Drejtorin e Cirkut Kombëtar Z. I.GJ., për shkeljet e evidentuara.</p> <p>Ministria e Kulturës të kërkoj dëmshpërblim për vlerën e përdorimit të pronës për periudhën 28.05.2019-28.05.2021, në masën 7,903,272 lekë, për shkak të mosveprimit të Drejtorit të Cirkut Kombëtar z. I.GJ..</p>
--	--

### **Observacion:**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar me shkresën nr.430 Prot., datë 06.12.2021, është paraqitur observacion nga z. I.GJ., në cilësinë e ish-Drejtorit të Cirkut Kombëtar, e cila ka përmbajtjen si më poshtë:

*Unë si titullar i institucionit nuk kam pasur asnjë informacion nga juristët e autorizuar për ndjekjen e këtij procesi si palë mbrojtëse, pasi nuk ka asnjë shkresë drejtuar Cirkut Kombëtar për njoftim.*

*Theksoj se gjatë procesit të marrjes së detyrës nuk më është dorëzuar puna nga paraardhësi në këtë detyrë dhe nuk më është bërë me dije ekzistenca e një konflikti gjyqësor...*

*Pasojat lidhur me çështjen në fjalë nuk kanë ardhur si rezultat i mos përcjelljes së vendimit të gjykatës nga Cirkut Kombëtar, por si rezultat i moskryerjes së detyrave nga përfaqësuesit ligjor të kësaj çështje. Në datën 12.07.2021 personalisht jam njohur me vendimin e përmbarimit për sekuestron konservative të asetëve të cirkut.*

*Lidhur me konstatimin e bërë mbi marrjen e fletëthirrjes nr. 3322, datë 05.12.2019, kam njoftuar në lidhje me zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 12.12.2019 nëpërmjet platformës whatsapp, znj. J.S., sekretare pranë Sekretares së Përgjithshme.....*

*Në lidhje me procesverbalin e datës 26.07.2021, znj. S.B. dhe z. L.H., kanë nënshkruar të dy pa lënë asnjë shënim mbi këtë procesverbal. Ndërhyrja në këtë procesverbal të datës 26.07.2021, duke cituar “nuk jam dakord me vërejtjen” është bërë ditën e nesërme të punës datë 27.07.2021, nga znj. S.B., me kërkesë të znj.M.D., veprim i cili sjell tjetërsim të një akti administrativ.*

### **Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:**

Në lidhje me procesin gjyqësor është e qartë përgjegjësia e titullarit në lidhje me administrimin e vendimit të gjykatës. Përgjegjësia e përfaqësuesve ligjor të Cirkut Kombëtar në këtë proces nuk përjashton nga përgjegjësia titullarin në lidhje me mos kryerjen e asnjë veprimi ligjor në lidhje me vendimin e gjykatës.

Në lidhje me faktin se titullari ka marrë dijeni në datën 12.07.2021 për vendimin e përmbarimit, sqarojmë që është një pretendim jo i vërtet për sa kohë referuar akteve të administruara evidentohet qartë që njoftimi i parë i zyrës përmbarimore është i datës 25.06.2020.

Në lidhje me njoftimin nëpërmjet aplikacionit whatsapp, përveç faktit që grupi nuk disponon asnjë dokument në lidhje me këtë pretendim, sqarojmë që ky lloj komunikimi nuk është komunikim zyrtar sipas parashikimeve të Kodi të Procedurave Administrative.

Në lidhje pretendimet mbi procesverbalin e datës 26.07.2021, nga shqyrtimi i përmbajtjes evidentohet qartë që përveç z. H. dhe z. GJ., personat e tjerë kanë shprehur mosdakortësinë në lidhje me procedurën.

Në lidhje me pretendimin se përgjegjësia për kaldajën është e shoqërisë që ruan objektin, bëjmë me dije se është një pretendim i pabazuar për sa kohë në asnjë moment institucioni nuk ka ngritur asnjë pretendim ndaj shoqërisë në lidhje me këtë fakt. Observacioni nuk merret në konsideratë.

### **Observacion:**

Me email e datës ka paraqitur observacion nga znj. J.S., në cilësinë e përfaqësueses së Cirkut Kombëtar në këtë proces gjyqësor

*Thirrja e Avokaturës së Shtetit si palë e interesuar në çështjen gjyqësore të Cirkut Kombëtar me palë paditëse "U" sh.p.k., duhej bërë nga vetë Gjykata dhe kjo është praktikë e konsoliduar tashmë.*

*Për më tepër po në Kodin e Procedurës Civile është përcaktuar qartë që gjykata thërret në gjyq Avokaturën e Shtetit kur çështja objekt gjykimi ka të bëjë me interesa shtetërore, të cilat kërkohet të mbrohen dhe nga Avokatura e Shtetit.*

*Konkretisht, në nenin 79/a të KPRC parashikohet shprehimisht: "Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin në rastet e parashikuara me ligj. Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim".*

*Me anë të ligjit nr. 3812017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", ndër të tjera, ka pësuar ndryshime edhe neni 35 i KPRC. Kështu, para vitit 2017, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë gjykohehin, ndër të tjera, çështjet me vlerë mbi 20 milion lekë, ndërsa me ndryshimet e reja, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë gjykohen: "Paditë me vlerë më shumë se 50 milionë lekë". Si e tillë, ka një pasaktësi në citimin e nenit 35 të KPRC me ndryshimet e reja të pësuar në vitin 2017, ndërsa padia është paraqitur në vitin 2018 (16.10.2018).*

*Ashtu sikurse jeni në dijeni për këtë çështje është bërë një Deklaratë Mbrojtje përpara prapësimit tim nga juriste znj. M.M. e caktuar së bashku me z. D.Z. për të ndjekur procesin gjyqësor. Kështu, e gjendur para faktit të një mbrojtje paraprake me argumentet dhe linjën e mbrojtjes së ndjekur nga juristët para meje, kam ndjekur edhe unë linjën e tyre.*

*Për më tepër, në prapësimet që unë kam paraqitur kam qenë në orientim të plotë për pjesën e mbrojtjes nga znj. E.D. pasi kurrsesi nuk mund të veproja pa një udhëzim nga eprorët e mi.*

*Objekti i padisë për pjesën e dëmshpërblimit është i qartë pasi referon për dëmshpërblim për përdorimin e truallit dhe jo dëmshpërblim jashtë kontraktor sikurse e referoni ju.*

*Linja e zgjedhur nga ana e juristëve përfaqësues të Cirkut Kombëtar në këtë çështje ka qenë të qëndronim mbi faktin se ishim në posedim të ligjshëm dhe të mos shkohej në pranimin e posedimit të paligjshëm dhe në keqbesim dhe më pas të konsiderohej instituti i parashkrimin, pasi nëse do vepronim kështu, do të ishim në pranim të pretendimit të palës paditëse se Cirkut Kombëtar ishte në posedim të paligjshëm dhe në keqbesim.*

*Ju bëj me dije gjithashtu se, pavarësisht faktit se de jure titullari im ka qenë znj. O.C. çdo praktikë gjyqësore e ndjekur nga sektori im është asistuar nga znj. D. e cila më herët e ka pasur pjesë të drejtorisë së saj sektorin e ankesave gjyqësore dhe ka njohur shumë mirë ecurinë e këtij procesi.*

*Bëj me dije se për procesin gjyqësor që unë kam përfaqësuar Cirkut Kombëtar (autorizim nr. 1474, datë 05.03.2019) ka qenë për pasurinë nr. 67282, ZK 8350, me sip. 1073 m2, me paditës U. sh.p.k, ku palë përfaqësuese për palën paditëse ka qenë z. P.R., për të cilin nuk rezulton të kem lidhje familjare apo konflikt interesi.*

*Njëkohësisht, ju informoj se mosparaqitja në seancën e fundit ka ndodhur për shkaqe objektive pasi është lehtësisht e verifikueshme që në datën kur është zhvilluar seanca e fundit e këtij procesi gjyqësor, rezultoj të kem qenë prezentë në punë por për shkak të angazhimeve të tjera të sektorit pasi isha e vetme në mbulimin e tij në atë periudhë, nuk kam arritur dot të jem në shpalljen e vendimit, gjë të cilën e kam komunikuar verbalisht tek eprorët e mi dhe jam mirëkuptuar për faktin se vendimi do të përcillet në institucion dhe do të vijonim proceduralisht.*

### **Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:**

Përgjegjësia e juristëve lidhet me faktin se nuk kanë qenë prezent në seancat gjyqësore dhe nuk kanë informuar strukturat përgjegjëse në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor. Po kështu, në kuadër të mbrojtjes së interesave të shtetit duhet që mbrojtja ligjore të ishte sa më e plotë duke shfrytëzuar të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me këtë proces gjyqësor. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë

### **Observacion:**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar me shkresën nr.1129/8 Prot., datë 07.12.2021, është paraqitur observacion nga znj. O.C., në cilësinë e ish-Drejtorit të Drejtorisë së mirë administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, e cila ka paraqitur observacionin si më poshtë:

*Pavarësisht se sipas strukturës organizative të Ministrisë së Kulturës, në linjë hierarkike kam qenë Drejtor i Drejtorisë së mirë administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, drejtori nga e cila varej Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, faktikisht procedurat gjyqësore menaxhoheshin nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, për arsyet e mëposhtme:*

*Drejtorisë së mirë administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, me Urdhër të Kryeministrit nr. 164, datë 5.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Kulturës”, iu shtuan funksionet e ankesave administrative dhe gjyqësore. Strukturë me 2 (dy) specialistë, e cila u plotësua në shkurt të vitit 2018, konkretisht me specialistët:*

- Z. E.B. emëruar në datë 21.02.2018 dhe larguar në datë 9.5.2018;
- Z. D.Z. emëruar në datë 20.02.2018 dhe larguar në datë 7.3.2019.

*Organizimi i kësaj drejtorie u bë shumë kompleks, duke kryer të gjitha funksionet horizontale së bashku si menaxhimi i burimeve njerëzore, arkiv-protokollit, çështjet juridike, mirëmbajtja, pritje përcjellje, shërbime brenda dhe jashtë vendit, si dhe shërbimet e tjera mbështetëse.*

*Për shkak të kompleksitetit të funksioneve të drejtorisë, nisur nga fakti që çështjet juridike më parë ishin ndjekur nga Drejtoria Juridike, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 179, datë 18,12,2016, dhe jo vetëm, për shkak edhe të vakancave në Sektorin e ankesave administrative dhe gjyqësore, të gjitha proceset gjyqësore kanë vazhduar të menaxhohen nga struktura rregullatore: Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.*

### **Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:**

Referuar strukturës organike institucionale të Ministrisë së Kulturës, Juristja znj. J.S. është pjesë e Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, sektor i cili është në varësi të Drejtorisë së mirë administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.

Po kështu në kushtet kur të gjitha pretendimet në lidhje me linjën e raportimit nuk kanë një akt ligjor i cili ta provojë, linjën e varësisë pretendimet nuk do të merret në konsideratë.

### **Observacion:**



Në vijim të Akt Konstatimit nr. 1, datë 24.11.2021, i Kontrollit të Lartë të Shtetit (Dokumenti nr.8), protokolluar me nr. 5551/3 prot., datë 24.11.2021, në pjesët kur deklaroni se mban përgjegjësi edhe Ministri i Kulturës, znj. E.M., janë paraqitur observacionet sa vijon:

*Sa i përket konkluzionit të arritur nga grupi i kontrollit, për shkeljet e evidentuara nga faqja 6 deri në faqen 10 të Akt Konstatimit nr. 1 datë 24.11.2021, ju bëjmë me dije se:*

*Ashtu sikurse vetë i keni cituar shkresat që MK ka pasur me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe Gjykatën e Apelit, po ashtu korrespondencat që MK ka pasur me Përmbauesin Gjyqësor Privat "K.B.S." sh.p.k, Degën e Thesarit Tiranë, Avokaturën e Shtetit, Policinë e Shtetit, etj., si dhe realizimin e hetimit administrativ ndaj titullarit të CK, z. I.GJ., lidhur me mos përcjelljen e vendimit nr. 8473 datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke dalë me masë disiplinore ndaj z. I.GJ., janë tregues më se të qartë se MK dhe titullari i saj ka kryer çdo veprim ligjor të mundshëm si dhe duke përdorur çdo mjet ligjor të disponueshëm në rrethanat e krijuara, për të mbrojtur interesat shtetërore/kulturore si dhe Çadrën e Cirkut Kombëtar.*

*Ndërkohë, mbi konkluzionin e arritur se "Përcaktimi i masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra", (ndaj drejtorit të CK z. I.GJ.), nuk është proporcionale në raport me shkeljet e evidentuara", shprehemi se marrja e një mase të tillë disiplinore është bërë në kuadër të marrjes parasysish të shkallës së ashpërsisë së dhënieve të masave disiplinore, ku në praktikën e konsoliduar tashmë prej vitesh, nuk mund të aplikohet masa disiplinore më e "ashpër" kur ndaj subjektit që merret masa disiplinore nuk ka pasur masë disiplinore të mëparshme, sikurse është dhe rasti i z. I.GJ..*

#### **Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:**

Në lidhje me procesin gjyqësor, nuk jemi shprehur në asnjë moment në lidhje me përgjegjësinë individuale të titullarit të institucionit të Ministrisë së Kulturës.

Përsa i përket masës disiplinore të marre ndaj titullarit të Cirkut Kombëtar dhe pretendimit se nuk ka pasur masë të mëparshme disiplinore, Ju bëjmë me dije se shkelja e evidentuar është shumë e rënde për shkak të pasojave institucionale dhe në këto kushte referuar edhe legjislacionit të fuqi aplikimi i një mase të tillë është jo proporcionale në raport me shkeljen. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

#### **Observacion:**

*Nëpërmjet autorizimit nr.421 prot., datë 04.12.2018 të Cirkut Kombëtar, jam një nga juristët e autorizuar për ndjekjen e procesit gjyqësor.*

*Duke qenë se shqyrtimi i procesit gjyqësor ka qenë në fazën e hetimeve paraprake si dhe bazuar në nenin 158 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë " i ndryshuar, detyra ime si juriste ka qenë hartimi i deklaratës së mbrojtjes si përfaqësuese e Cirkut Kombëtar, detyrë të cilën e kam përmbyshur nëpërmjet aktit nr. 42/1 prot., 07.12.2018 "Deklarata e mbrojtjes" ku parashtrohen faktet dhe argumentet ligjore mbi pretendimet e ngritura në kërkesëpadi.*

*Nëpërmjet autorizimit me nr.1474 prot., datë 05.03.2019 të Ministrisë së Kulturës unë nuk jam më juristi i autorizuar për ndjekjen në vazhdimësi të këtij procesi gjyqësor.*

*Referuar autorizimit të sipërcituar si dhe bazuar në pikën 3 të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" në të cilin parashikohet se "Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë." si dhe germës "c" të nenit 96 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës civile i Republikës së Shqipërisë " i ndryshuar në të cilën parashikohet se: "Si përfaqësues të palëve me prokurë mund të jenë: c) juristët dhe punonjësit e tjerë të autorizuar të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë;" unë nuk jam më juristi i autorizuar për të*

*ndjekur procesin gjyqësor pasi ka një autorizim të mëvonshëm që nuk më cakton mua si juristen përgjegjëse për ndjekjen në vijim të saj.*

*Bazuar në faktet dhe argumentet më sipër, ju bëj me dije se detyrat e mia si juriste janë përmbushur brenda periudhës kohore në të cilën unë kam qenë e autorizuar.*

### **Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:**

Në kushtet kur jeni autorizuar si përfaqësues të Cirkut Kombëtar, sipas autorizimit përkatës dhe në mungesë të një akti që shfuqizon/anulon këtë akt ju do të mbani përgjegjësi sipas periudhës të cilës keni qenë të angazhuar.

Observacionet do të merren në konsideratë pjesërisht.

### **Observacion**

Me shkresën nr. 666/1, datë 24.01.2022 të Ministrisë së Kulturës janë dërguar observacione në lidhje me Projekt-Raportin, në përmbajtje të të cilës nuk ka patur pretendime mbi faktet e evidentuara por është shprehur dakortësia, duke i bërë me dije angazhimin institucional për të vepruar në lidhje konstatimet e grupit të auditimit.

*Në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, referuar ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile të vitit 2017, rezulton se me anë të ligjit nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, ndër të tjera, ka pësuar ndryshime edhe neni 35 i KPRC. Kështu, para vitit 2017, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë gjykoheshin, ndër të tjera, çështjet me vlerë mbi 20 milion lekë, ndërsa me ndryshimet e reja, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë gjykohen: “Paditë me vlerë më shumë se 50 milionë lekë”. Si e tillë, ka një pasaktësi në citimin e nenit 35 të KPRC me ndryshimet e reja të pësuara në vitin 2017, ndërsa padia është paraqitur në vitin 2018 (16.10.2018).*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Në këto kushte observacioni i paraqitur do të merret parasysh në lidhje me këtë konstatim.

### **III.2.2 Zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave në institucionin e Cirkut të Tiranës.**

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit nr.1129/2 datë 25.10.2021, mbi Auditimin Tematik në Ministrinë e Kulturës dhe Cirkun e Tiranës, është shqyrtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- 1)Struktura organizative e Cirkut Kombëtar (Cirku);
- 2)Vendimet për emërimet, largimet dhe zbatimin strukturave organizative, për periudhën 01.01.2019 - 30.09.2021;
- 3)Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit;
- 4)Kontratat individuale të punonjësve të rekrutuar gjatë periudhës objekt auditimi;
- 5) Listëpagesat mujore dhe librat e pagave për periudhën 01.01.2019 - 30.09.2021.


#### ***a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.***

#### **Struktura organizative**

Cirku ushtron aktivitetin e tij në përputhje dhe në zbatim të Ligjit 10352, datë 18.11.2010 për artin dhe Kulturën, i ndryshuar, Rregullores së Brendshme nr. 116 prot, datë 11.03.2013 dhe Statutit. Ky institucion është në varësi të Ministrisë së Kulturës, me seli qendrore në Tiranë. Organika dhe struktura e Cirkut përcaktohet me Urdhër të Kryeministrit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Cirku Kombëtar, gjatë periudhës objekt auditimi, ka kryer funksionet e tij me 38 punonjës, duke u bazuar në strukturën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 134, datë 28.03.2014, òPër miratimin e strukturës dhe organikës së Cirkut Kombëtarò. Sipas kësaj strukture, Cirku ka qenë i organizuar mbi bazën e 3 sektorëve të varur direkt nga Drejtori i institucionit: Sektori Teknik, Sektori Artistik dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse. Organigrama e Cirkut ka funksionuar si më poshtë:



*Organigrama e Cirkut Kombëtar*

***b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.***

***Dosjet e personelit***

Grupi i auditimit ka konstatuar se dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse duke u bazuar në VKM nr 117, datë 05.03.2014 òPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 òPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò, e cila përcakton se:

- 1. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.*
- 2. Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrive, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale.*

Sa i përket dokumenteve që duhet të jenë në dosjet e të punësuarve, baza ligjore në fuqi përcakton se:

- Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:*
- Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar.*
  - Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes.*
  - Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon: fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë); certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht). Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e*

*njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; listë e notave, nëse “nota mesatare” është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; dokument i laurimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfituar jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës; dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; akti i emërimit në pozicionin e punës; akti i dhënies së masës disiplinore; librezja e punës; raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noter.*

Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 3 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi. Gjatë auditimit të dosjeve të kampionuara të personelit, janë konstatuar parregullsi dhe mangësi në dokumentacion si më poshtë:

<b>Punonjësi</b>	<b>Pozicioni i punës</b>	<b>Problematika në dosjen personale</b>
S.F.	Akrobat	-
M.E.	Akrobat	Mungon dëshmia e penalitetit.
A.D.	Këpucar	-

**1. Në shqyrtimin e dosjeve të personelit, grupi i auditimit ka konstatuar mangësi të dokumentacionit, si:**

**- në të gjitha dosjet e përzgjedhura mungon fleta prezantuese e punonjësit;**

**- në një dosje mungon dëshmia e penalitetit.**

Në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit, VKM nr 117 datë 5.03.2014 për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit, dokumentacioni në dosjet e personelit ka disa mangësi.

*Observacioni i Ministrisë së Kulturës me shkresën nr. 6661/1 prot., datë 24.01.2022*

### **Pretendimi i subjektit**

Në lidhje me këtë gjetje, subjektet në auditim na vënë në dijeni se janë plotësuar dosjet në të cilat mungonte fleta prezantuese e punonjësit dhe dëshmia e penalitetit që mungonte në dosjen e M.E. Dokumentet në fjalë ishin vendosur bashkëlidhur observacionit.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Observacioni i MK është pranuar nga grupi i auditimit dhe ndryshimet janë reflektuar në rekomandimin përkatës.

### **Marrëdhëniet e Punës**

Marrëdhëniet e punës të punonjësve të Cirkut Kombëtar rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar. Sektori i Shërbimeve Mbështetëse ka në strukturë 3 punonjës, 1 Përgjegjës, 1 magazinier dhe 1 specialist arkiv-protokolli.

### ***Kontratat e punës***

Grupi i auditimit ka përzgjedhur 9 Kontrata Individuale të Punës të punonjësve pjesë e strukturës së Cirkut. Në Kodin e Punës, Neni 21 pika 3 përcaktohet se:

*Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos:*

*a) identitetin e palëve; b) vendin e punës; c) përshkrimin e përgjithshëm të punës; ç) datën e fillimit të punës; d) kohëzgjatjen, kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; dh) kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; e) afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; ë) elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; f) kohën normale javore të punës; g) referenca në kontratën kolektive në fuqi; gj) periudhën e provës; h) llojet dhe procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive;*

**2. Në shqyrtimin e elementëve që duhet të jenë në kontratën e punës, u konstatua se në kundërshtim me Pikën 3, Neni 21, Kodi i Punës, Kontrata Individuale e Punës nuk i përfshin të gjitha elementet përbërëse të pagës, siç është data e dhënies së saj.**

*Observacioni i Ministrisë së Kulturës me shkresën nr. 6661/1 prot., datë 24.01.2022*

### **Pretendimi i subjektit**

Në lidhje me këtë gjetje, subjektet në auditim na vënë në dijeni se kontratat aktuale të punonjësve të Cirkut Kombëtar skadojnë në qershor të vitit 2022 dhe në kontratat e reja do të përfshihen elementët që mungojnë.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Observacioni i MK është pranuar nga grupi i auditimit dhe zbatimi i rekomandimit do të ndiqet nga auditimet e radhës.

### ***Rekrutimet dhe ndryshimet në kategori***

*Procedura e punësimit me kontratë pune* është realizuar sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Për periudhën objekt auditimi, në Cirkun Kombëtar janë rekrutuar gjithsej 7 punonjës, si dhe është emëruar Drejtori i institucionit. Në 4 dosjet e rekrutimit të punonjësve të shqyrtuara nga grupi i auditimit, është respektuar periudha 3-mujore e provës. Megjithatë, nuk konstatohet asnjë dokument provues për zhvillimin e konkursit apo asnjë dokument tjetër mbështetës që të paraqesë specifikat/specialitetet e akrobatit, si p.sh. një relacion shpjegues nga specialistët e fushës. Për më tepër, nuk gjendet asnjë informacion për disiplinat apo numrat që kryejnë akrobatët e rekrutuar gjatë 2020.

**3. Kjo bie në kundërshtim me Nenin 4 të Rregullores së Brendshme të institucionit “Punonjësit e Cirkut Kombëtar punësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me konkurs dhe pas kalimit të periudhës së provës. Për zhvillimin e konkurseve ngrihet një komision me përbërje të specialistëve të fushës.”**

Gjatë kësaj periudhe ka pasur gjithsej 6 lëvizje kategorie të stafit, 4 ngritje në kategori dhe 2 ulje në kategori. Bazuar në shkresën me nr.43 prot, datë 22.01.2020, drejtuesi artistik ka kërkuar relacion tekniko-profesional për 5 kandidatë. Në lidhje me këtë çështje, më datë 23.01.2020 u mbajt një mbledhje ku merrte pjesë drejtori i institucionit dhe mjeshtrat e profilit të Cirkut (Procesverbal nr.48 prot, datë 23.01.2020). Pas përgjigjes së mjeshtrave të profilit, drejtuesi artistik ka hartuar relacionin përmbledhës nr.61 prot, datë 28.01.2020, ku pasi analizonte mendimet e personave kompetentë, i propozonte drejtorit të institucionit ngritjen në detyrë të 3

prej këtyre kandidatëve. Në vijim, Drejtori ka marrë parasysh vetëm dy prej këtyre propozimeve dhe ka vendosur ngritjen në kategori të znj. I.D. dhe z. G.Sh me Urdhrat e Brendshëm nr.64 prot dhe nr.65 prot, datë 29.01.2020.

Më datë 22.12.2020, Drejtori vendos të ulë në detyrë znj. I.D. dhe të ngrejë në detyrë z. R.Z., përkatësisht me shkresat nr. 345 prot dhe nr. 349 prot, datë 22.12.2020.

Me anë të shkresave nr.79 prot dhe 80 prot, datë 08.04.2021, Drejtori i institucionit ka zhbërë veprimin e mëparshëm duke ngritur në pozicion përsëri znj. I.D. dhe ulur z. R.Z.

#### **4. Në lidhje me këto lëvizje në kategori të punonjësve nuk ka asnjë relacion shpjegues apo motivacion të dokumentuar nga ana e Cirkut Kombëtar.**

Në një nga mbledhjet e institucionit, Drejtori është shprehur se do të kishte lëvizje në kategori për të vlerësuar dhe motivuar akrobatët që performojnë mirë. Megjithatë, këto lëvizje në kategori duhet të jenë të mbështetura mirë në vlerësimet dhe relacionet e personave përgjegjës. Për shembull, relacionet e Mjeshtreve të Profilit tregonin znj. I.D. ishte një artiste e kompletuar dhe me risi.

**Mangësitë në procedurën e rekrutimeve të reja dhe lëvizjet e pajustificuara në kategori të punonjësve janë përgjegjësi e Drejtorit të institucionit. Për sa më sipër, me kryerjen e këtyre veprimeve është shkelur neni 4/2 i Rregullores së Brendshme “Të drejtën e lidhjes së kontratës e ka Drejtori.” dhe neni 4/6 “Kur vërehen rënie të aftësive apo edhe mos nxjerrje e numrave të rinj në shfaqje, Drejtori mund të riklasifikojë kategorizimin e punonjësve të cilët nuk i përgjigjen kategorisë respektive.”**

#### **Observacion**

*Në lidhje me këtë gjetje, me shkresën nr. 6661/1 prot., datë 24.01.2022, subjektet në auditim na vënë në dijeni se Mjeshtret e Profileve do të marrin masa për të kryer vlerësimet e duhura për akrobatët e rekrutuar rishtazi dhe çdo ndryshim në kategori do të jetë i mbështetur në relacionet e tyre, sipas Rregullores së Brendshme të Cirkut Kombëtar.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Observacioni i MK është pranuar nga grupi i auditimit dhe zbatimi i rekomandimit do të ndiqet nga auditimet e radhës.

#### **Largimet**

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2019-30.09.2021, në Cirkun Kombëtar i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 4 punonjësve, 2 prej të cilëve kanë mbushur moshën për pensionin e pleqërisë, përkatësisht me shkresën nr.76 prot, datë 31.01.2020 dhe shkresën nr.191 prot, datë 30.04.2020. Dy punonjës të tjerë kanë dhënë dorëheqjen dhe janë larguar me shkresën nr. 25 prot, datë 24.01.2019 dhe shkresën nr. 638 prot, datë 02.12.2019.

#### **Marrëdhëniet e pagave**

Marrëdhëniet e pagave në Cirkun Kombëtar janë të përcaktuara sipas funksionit dhe kontratave të lidhura në linjë me dispozitat e Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 oKodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit (përmbledhëseve mujore të listëpagesave të punonjësve; borderotë e pagave), dhe pagesat e kryera sipas urdhër-shpenzimeve janë si më poshtë:

Për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave. U audituan me zgjedhje listëpagesat e muajve Tetor - Nëntor - Dhjetor 2019; Tetor - Nëntor -

Dhjetor 2020, si dhe Janar - Shkurt - Mars 2021. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se përlllogaritjet e dhënia e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi. Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se janë shoqëruar me listëprezencat në punë, të përgatitura nga përgjegjësit respektivë, si dhe janë nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës, si dhe Drejtori i Institucionit.

Në sektorin e financave, lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 òPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 òPër tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 òPër tatimin mbi të ardhurat.

Për sa më lart, bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, u arrit në gjetjet e auditimit si më poshtë vijon:

<b>Titulli i gjetjes</b>	Mangësi në menaxhimin e Burimeve Njerëzore
<b>Situata:</b>	<p>- Administrimi i dosjeve të personelit nuk është bërë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi. Në shqyrtimin e dosjeve të personelit, grupi i auditimit ka konstatuar disa mangësi të dokumentacionit. Grupi i auditimit, i është referuar VKM nr. 833, datë 28.10.2020 òPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, VKM nr 117 datë 5.03.2014 òPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit ku përcaktohen dokumentet qe duhet të mbajë dosja e të punësuarit. Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit është konstatuar mangësi në dokumentacion, konkretisht fleta prezantuese e punonjësit në të gjitha dosjet e audituara dhe dëshmia e penaltetit në një dosje. Këto mangësi janë rregulluar nga subjekti, referuar observacionit me shkresë nr. 6661/1 prot., datë 24.01.2022.</p> <p>- Në shqyrtimin e elementëve që duhet të jenë në kontratën e punës, u konstatua se në kundërshtim me Pikën 3, Neni 21, Kodi i Punës, Kontrata Individuale e Punës nuk i përfshin të gjitha elementet përbërëse të pagës, si datën e dhënies së saj.</p> <p>- Në dosjet e rekrutimit të punonjësve të shqyrtuara nga grupi i auditimit, nuk konstatohet asnjë dokument provues për zhvillimin e konkursit apo asnjë dokument tjetër mbështetës që të paraqesë specifikat/specialitetet e akrobatit, si p.sh. një relacion shpjegues nga specialistët e fushës. Për më tepër, nuk gjendet asnjë informacion për disiplinat apo numrat që kryejnë akrobatët e rekrutuar gjatë 2020. Kjo është në kundërshtim me Nenin 4 të Rregullores së Brendshme të institucionit òPunonjësit e Cirkut Kombëtar punësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me konkurs dhe pas kalimit të periudhës së provës. Për zhvillimin e konkurseve ngrihet një komision me përbërje të specialistëve të fushës.ò</p> <p>- Në lidhje me lëvizjet e shpeshta në kategori të punonjësve nuk ka asnjë relacion shpjegues apo motivacion të dokumentuar nga ana e Cirkut Kombëtar dhe janë të pambështetura në vlerësimet dhe relacionet e personave përgjegjës (Mjeshtrove të profilit).</p>

<b>Kriteri:</b>	-VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit; -VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; - Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Neni 21; -Rregullorja e brendshme e Cirkut Kombëtar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi sjell që dokumentacioni në dosjet personale të punonjësve nuk është i plotë; Rekrutimet e reja dhe lëvizjet në kategori të akrobatëve të pambështetura në vlerësimet dhe relacionet e personave përgjegjës cenojnë jo vetëm bazën ligjore, por edhe cilësinë e numrave apo shfaqjeve të Cirkut Kombëtar.
<b>Shkaku:</b>	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi për administrimin e dosjeve të personelit; Rekrutimet e reja dhe lëvizjet në kategori të akrobatëve të pambështetura në vlerësimet dhe relacionet e personave përgjegjës.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme / E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	- Në vijimësi, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Cirkun Kombëtar të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin e nevojshëm, sipas bazës ligjore në fuqi. - Të merren masa nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse për përfshirjen e datës së dhënies së pagës në kontratat individuale të punës tip, sipas bazës ligjore në fuqi. - Në vijimësi, të kryhen vlerësime nga Mjeshtrat e profilit për akrobatët e rekrutuar rishtazi në institucion dhe çdo ndryshim në kategori të jetë i mbështetur në vlerësimet dhe relacionet e profesionistëve përkatës.

### **III.2.3 Procedura e dokumentimit, ruajtjes, qarkullimit dhe nxjerrjes nga përdorimi i sistemit të ngrohjes së institucionit.**

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadër të menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë dhe cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Referuar inventarit të mallrave, të vitit 2020 rezulton gjendje sistemi i ngrohjes së institucionit në vlerën 957,659 lekë.

Në zbatim të njoftimit të sipërcituar zyra përmbartimore òK.B.S.ò sh.p.k ka vijuar me kryerjen e veprimeve përmbartimore me qëllim ekzekutimin e vendimit gjyqësor, veprime të cilat pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura në datë 20.10.2021, datë 21.10.2021, datë 28.10.2021 dhe 29.10.2021.

Ky proces filloi me inventarizimin e sendeve të luajtshme të ndodhura në palestrën dhe arenën e Çadrës së Cirkut. Pas përfundimit të kësaj procedure dhe mbylljes së procesverbalit datë 20.10.2021, u vendos që ambienti ti lihej në ruajtje shoqërisë së ruajtjes fizike òN.ò dhe personave të caktuar në autorizim të palës kreditore.



Referuar përmbajtjes së procesverbalit evidentohet se zyra përbarimore òK.B.S.ò sh.p.k i ka komunikuar Drejtorit të Cirkut Kombëtar, që të vendos një përfaqësues të palës debitorë gjatë procedurës së inventarizimit. Rezulton se Drejtori i Cirkut Kombëtar nuk ka ndërmarr asnjë veprim në lidhje me këtë fakt pasi, nuk kishte komunikim shkresor ose elektronik nga institucioni epror në lidhje me vijueshmërinë e procedurës së inventarizimit.

Pavarësisht kësaj rezulton se gjatë procedurës së inventarizimit kanë qenë prezent Drejtori i Cirkut Kombëtar, z. I.GJ. dhe Përgjegjësi i Sektorit Teknik i Cirkut Kombëtar z. L.H., të cilët kanë firmosur në fund të procesverbalit me shënimin *“I pranishëm por refuzoj procesin”*.

Referuar përmbajtjes së procesverbalit të datës 20.10.2021 dhe 29.10.2021, mungon sistemi i ngrohjes, në listën e sendeve të luajtshme të inventarizuara.

**Grupi i auditimit gjatë auditimit në terren, pas këqyrjes së ambienteve ku ka qenë e vendosur Çadra e Cirkut, me procesverbalin e mbajtur në datë 17.11.2021, në prani të personit i cili e ka pasur në ngarkim, z. K.Z. (mekanik), ka konstatuar fizikisht se sistemi i ngrohjes nuk ndodhet në ambientet e Cirkut Kombëtar. Personi i cili e ka pasur në ngarkim, sipas fletës së inventarit të datës 04.05.2012, evidenton në procesverbal se nuk ka dijeni se ku ndodhet pjesa e djegies së karburantit të sistemit të ngrohjes.**

**Këto veprime janë në shkelje të Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, neni 22, neni 24. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve”, pika 5, 10,11,21.**

**Drejtori i Cirkut Kombëtar nuk ka urdhëruar ngritjen e komisionit të aktiveve me qëllim marrjen në dorëzim të aktiveve gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës.**

Për sa më lart, bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, u arrit në gjetjet e auditimit si më poshtë vijon:

<b>Titulli i gjetjes</b>	Mangësi në procedurat e dokumentimit, ruajtjes, qarkullimit dhe nxjerrjes nga përdorimi i kaldajës së institucionit
<b>Situata:</b>	- Grupi i auditimit gjatë auditimit në terren, pas këqyrjes së ambienteve ku ka qenë e vendosur Çadra e Cirkut, me procesverbalin e mbajtur në datë 17.11.2021, në prani të personit i cili e ka pasur në ngarkim, z. K.Z. (mekanik), ka konstatuar fizikisht se sistemi i ngrohjes nuk ndodhet në ambientet e Cirkut Kombëtar. Personi i cili e ka pasur në ngarkim, sipas fletës së inventarit të datës 04.05.2012, evidenton në procesverbal se nuk ka dijeni se ku ndodhet pjesa e djegies së karburantit të sistemit të ngrohjes.
<b>Kriteri:</b>	- <i>Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, neni 22, neni 24.</i> - <i>Udhëzimin nr. 30, datë “Për menaxhimin e aktiveve”, pika 5, 10,11,21.</i>
<b>Ndikimi/Efkti:</b>	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi ka sjellë mungesën fizike të sistemit të ngrohjes në ambientet e Cirkut Kombëtar dhe mungesë të dijenisë së personit që e ka pasur në ngarkim se ku ndodhet pjesa e djegies së karburantit të sistemit të ngrohjes.
<b>Shkaku:</b>	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi për menaxhimin e aktiveve; Mungesë të sistemit të ngrohjes në ambientet e Cirkut Kombëtar.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme / E lartë

<b>Rekomandimi:</b>	- Cirkul Kombëtar të marrë masa për arkëtimin e vlerës së kaldajës nga personat përgjegjës.
---------------------	---

### **Observacion:**

Me shkresën nr.430 Prot., datë 06.12.2021, është paraqitur observacion nga z. I.GJ., në cilësinë e ish-Drejtorit të Cirkut Kombëtar, e cila ka paraqitur observacionin si më poshtë:

*Në lidhje me kaldajën e djegies, institucioni ka nën shërbim SH.P.S.F “D.S.”, për ruajtjen e objektit kundrejt një kontrate të nënshkruar sipas një procedure prokurimi, e cila ka në përgjegjësi të gjitha sendet dhe objektet të cilat janë pjesë e aktiveve të Cirkut Kombëtar.*

### **Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH:**

Përgjegjësia e SH.P.S.F oD.S.ö, për ruajtjen e objektit, nuk përjashton nga përgjegjësia strukturat përgjegjëse të institucionit në lidhje me menaxhimin e aktiveve.

Në këto kushte observacioni nuk merret në konsideratë.

### **III.2.4 Zbatimi i dispozitave ligjore në procedurën e emërimit të Drejtorit të Cirkut Kombëtar z. I.GJ..**

Drejtori aktual i institucionit z. I.GJ. është emëruar me anë të VKM-së nr. 858, datë 24.12.2019 për emërimin në detyrë të Drejtorit të Cirkut Kombëtar.

Grupi i auditimit kërkoi pranë Ministrisë së Kulturës dosjen me dokumentacionin mbështetës dhe procedurën e konkurrimit për emërimin e Drejtorit të Cirkut Kombëtar.

Dokumentet e vetme të vëna në dispozicion në lidhje me këtë çështje ishin VKM-ja nr. 858, datë 24.12.2019 dhe relacioni i Ministrit të Kulturës për projektvendimin për emërimin në detyrë të Drejtorit të Cirkut Kombëtar, ku theksohet se në kushtet e nevojës emergjente për caktimin e një titullari në Cirkul Kombëtar, propozohet kandidatura në fjalë pa ndonjë procedurë konkurrimi.

**Në mungesë të zhvillimit procedurës së konkurrimit nga ana e Ministrit të Kulturës, nuk janë plotësuar kërkesat e Nenit 9/3 të Ligjit 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe Kulturën”, i ndryshuar, i cili parashikon se “Emërimi i titullarit të institucionit publik qendror bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave pas procedurave të konkurrimit të zhvilluara nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën”.**

### **Observacion**

Në lidhje me këtë gjetje, me shkresën nr. 6661/1 prot., datë 24.01.2022, Ministria e Kulturës na bën me dije se me VKM nr. 790, datë 15.12.2021, me propozim të Ministrit të Kulturës, është bërë lirimi nga detyra i z. I.GJ..

*Gjithashtu, MK është duke përgatitur shpalljen publike për pozicionin e Drejtorit të Cirkut Kombëtar.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit**

Observacioni i MK është pranuar nga grupi i auditimit dhe ndryshimet janë reflektuar në rekomandimin përkatës.

Për sa më lart, bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, u arrit në gjetjet e auditimit si më poshtë vijon:

<b>Titulli i gjetjes</b>	Mangësi në procedurën e emërimit të Drejtuesit të Cirkut Kombëtar
--------------------------	---

<b>Situata:</b>	- Drejtori aktual i institucionit z. I.Gj. është emëruar me anë të VKM-së nr. 858, datë 24.12.2019 òPër emërimin në detyrë të Drejtorit të Cirkut Kombëtarò. Dokumentet e vetme që MK dispononte në lidhje me këtë procedurë ishin VKM-ja nr. 858 e miratuar dhe relacioni i Ministrisë të Kulturës për òProjektvendimin për emërimin në detyrë të Drejtorit të Cirkut Kombëtarò, ku theksohet se në kushtet e nevojës emergjente për caktimin e një titullari në Cirkun Kombëtar, propozohet kandidatura në fjalë pa ndonjë procedurë konkurrimi. Në relacion shpjegohet se kandidatura është propozuar në kushtet e emergjencës dhe nevojës së ngutshme për një drejtues, por kanë kaluar rreth dy vite që nga emërimi në fjalë.
<b>Kriteri:</b>	Neni 9/3 i Ligjit 10352, datë 18.11.2010 òPër artin dhe Kulturënò, i ndryshuar, òEmërimi i titullarit të institucionit publik qendror bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave pas procedurave të konkurrimit të zhvilluara nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën.ò
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi bën që procedura e emërimit të Drejtorit të Cirkut Kombëtar të ketë mangësi.
<b>Shkaku:</b>	Mos zhvillimi i procedurave të konkurrimit të zhvilluara nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën për emërimin e Drejtorit të Cirkut.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Nuk lihet rekomandim në kushtet kur referuar VKM-së nr. 790, datë 15.12.2021 është vendosur lirimi nga detyra i Drejtorit të Cirkut Kombëtar Z. I.GJ..

**Për trajtimin e bërë më sipër janë mbajtur akt-konstatimet nr.1 dhe 2, datë 24.11.2021**

## **V. GJETJE DHE REKOMANDIME**

**Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i fashikullit të gjykimit të procesit gjyqësor me palë paditëse Shoqëria òUò shpk dhe palë e paditur Cirkun Kombëtar, rezulton se janë zhvilluar 15 seanca gjyqësore dhe vetëm për 2 prej tyre rezulton të ketë memo informuese nga ana e juristes së Ministrisë së Kulturës znj. J.S., drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së mirë administrimit të Burimeve Njerëzore , Aseteve dhe Shërbimeve, i cili është përgjegjës për sektorin e ankesave administrative dhe gjyqësore dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Në lidhje me seancat e tjera të zhvilluara nuk rezulton të ketë asnjë informacion se çfarë ka ndodhur gjatë shqyrtimit gjyqësor në këto seanca, në shkelje të përcaktimeve të pikës 3 të nenit 46 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës. Po kështu, rezulton që përfaqësuesit e autorizuar kanë munguar në 2 seancat e fundit gjyqësore dhe në këto kushte gjykata ka shtyrë seancat gjyqësore për shkak të mungesës së përfaqësueses së palë së paditur Cirkut Kombëtar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet (12-19) të Raportit të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Ministria e Kulturës dhe Cirkun Kombëtar të marrin masa që të kenë informacion nga përfaqësuesit e autorizuar, për çdo seancë, në lidhje me ecurinë e proceseve gjyqësore dhe njëkohësisht të marrin masa që përfaqësuesit ligjor të institucionit të jenë prezent në çdo seancë gjyqësore në proceset në ndjekje.

**Në vijimësi**

**2.Gjetje nga auditimi:** Referuar përmbajtjes së prapësimeve të procesit gjyqësor me palë paditëse Shoqëria òUò shpk dhe palë e paditur Cirku Kombëtar, konstatohet se në asnjë moment nga përfaqësuesi ligjor i Cirkut Kombëtar nuk janë ngritur pretendime në lidhje me mos thirrjen e Avokaturës së Shtetit në këtë proces gjyqësor, si subjekt i interesuar, bazuar në përcaktimet e nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 5 të Ligjit nr. 10018/2008 òPër Avokaturën e Shtetitò.

Referuar qëndrimeve të përfaqësues së Cirkut Kombëtar znj. J.S., në kushtet kur pretendimi i palës paditëse ka qenë për një posedim të ligjshëm për afërsisht 50 vjet, nuk është ngritur asnjëherë pretendimi, nëpërmjet një kundërpadie në lidhje me ekzistencën e kushteve të fitimit të pronësisë nga Cirku Kombëtar për truallin objekt gjykimi, nëpërmjet parashkrimit fitues. Nuk rezulton që përfaqësuesit e autorizuar të kenë ngritur pretendime në lidhje me afatet e parashkrimit të kërkesëpadisë për dëmshpërblim, e cila referuar rastit konkret është kërkim për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe është 3 vjet. Në kushtet kur pala paditëse është vënë në dijeni në momentin e kryerjes së transaksionit në vitin 2011 dhe padia është paraqitur në 2019 rezulton se kanë kaluar 8 vjet. Po kështu, nuk rezulton të jetë kontestuar pretendimi në lidhje me dëmin e shkaktuar, qëndrim të cilin e ka mbajtur edhe Avokatura e Shtetit në ankimin e paraqitur në gjykatë së bashku me kërkesën për rivendosje në afat të të drejtës së ankimit. *(Më hollësisht trajtuar në faqet (12-19) të Raportit të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Ministria e Kulturës dhe Cirku Kombëtar të marrin masa që qëndrimet në lidhje me proceset gjyqësore, ti nënshtrohen shqyrtimit të hallkave institucionale përgjegjëse, para se të dërgohen në gjykatë, me qëllim që përfaqësimi ligjor të jetë sa më i plotë dhe efektiv.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Vendimi nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është protokolluar pranë Cirkut Kombëtar me nr. 26, datë 17.01.2020 dhe duhet të ishte ankimuar brenda 03.02.2020, sipas parashikimeve të nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile. *(Më hollësisht trajtuar në faqet (12-19) të Raportit të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Cirku Kombëtar të hartoj një metodologji për procedurën e dërgimit të praktikave protokollare te titullari i institucionit dhe kalimin e këtyre praktikave te strukturat përgjegjëse, me qëllim dokumentimin e procesit dhe përcaktimin e përgjegjësive.

### **Menjëherë**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit në Cirkun Kombëtar, u konstatua mangësi e dokumentacionit, si: në te gjitha dosjet e përzgjedhura mungon fleta prezantuese e punonjësit; në një dosje mungon dëshmia e penaltetit, në kundërshtim me Lidhjen 1 të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 òPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 òPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò. Gjithashtu, nga shqyrtimi i elementëve që duhet të jenë në kontratat individuale të punës, u konstatua se në kundërshtim me Pikën 3, Neni 21, Kodi i Punës, kontratat individuale të punës të përzgjedhura nuk i përfshijnë të gjitha elementet përbërëse të pagës, siç është data e dhënies së saj. *(Më hollësisht trajtuar në faqet (25-31) të Raportit të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Cirkun Kombëtar të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin e nevojshëm dhe përfshirjen e datës së dhënies së pagës në kontratat individuale të punës tip, sipas bazës ligjore në fuqi.

**Në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të personelit, për periudhën objekt auditimi, në Cirkun Kombëtar janë rekrutuar gjithsej 7 punonjës, si dhe është emëruar drejtori i institucionit. Në 4 dosjet e rekrutimit të punonjësve të shqyrtuara nga grupi i auditimit nuk konstatohet asnjë dokument provues për zhvillimin e konkursit apo asnjë dokument tjetër mbështetës që të paraqesë specifikat/specialitetet e akrobatit, si p.sh. një relacion shpjegues nga specialistët e fushës. Për më tepër, nuk gjendet asnjë informacion për disiplinat apo numrat që kryejnë akrobatët e rekrutuar gjatë 2020. Kjo bie në kundërshtim me Nenin 4 të Rregullores së Brendshme të institucionit ÷Punonjësit e Cirkut Kombëtar punësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me konkurs dhe pas kalimit të periudhës së provës. Për zhvillimin e konkurseve ngrihet një komision me përbërje të specialistëve të fushës.

Lëvizjet në kategori të punonjësve nuk kanë asnjë relacion shpjegues apo motivacion të dokumentuar nga ana e Cirkut Kombëtar. Mangësitë në procedurën e rekrutimeve të reja dhe lëvizjet e pajustificuara në kategori të punonjësve janë përgjegjësi e Drejtorit të institucionit. Për sa më sipër, me kryerjen e këtyre veprimeve është shkelur neni 4/2 i Rregullores së Brendshme ÷Të drejtën e lidhjes së kontratës e ka Drejtori.÷ dhe neni 4/6 ÷Kur vërehen rënie të aftësive apo edhe mos nxjerrje e numrave të rinj në shfaqje, Drejtori mund të riklasifikojë kategorizimin e punonjësve të cilët nuk i përgjigjen kategorisë respektive.

**5.1 Rekomandimi:** Sektori Artistik në Cirkun Kombëtar të kryejë vlerësime në vijimësi nga Mjeshtrat e Profilit për akrobatët e rekrutuar rishtazi në institucion dhe çdo ndryshim në kategori të jetë i mbështetur në vlerësimet dhe relacionet e profesionistëve përkatës.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së emërimit të drejtorit të Cirkut Kombëtar z.I.GJ., rezulton se ai është emëruar me anë të VKM-së nr. 858, datë 24.12.2019 ÷Për emërimin në detyrë të Drejtorit të Cirkut Kombëtar. Grupi i auditimit kërkoi pranë Ministrisë së Kulturës dosjen me dokumentacionin mbështetës dhe procedurën e konkurrimit për emërimin e Drejtorit të Cirkut Kombëtar. Dokumentet e vetme të vëna në dispozicion në lidhje me këtë çështje ishin VKM-ja nr. 858 e miratuar dhe relacioni i Ministrit të Kulturës për ÷Projektvendimin për emërimin në detyrë të Drejtorit të Cirkut Kombëtar, ku theksohet se në kushtet e nevojës emergjente për caktimin e një titullari në Cirkun Kombëtar, propozohet kandidatura në fjalë pa ndonjë procedurë konkurrimi. Kushtet e nevojës emergjente nuk janë të përcaktuara në asnjë akt ligjor dhe kjo situatë ka zgjatur për më tepër se një vit e gjysmë. Në mungesë të zhvillimit procedurës së konkurrimit nga ana e Ministrit të Kulturës, nuk janë plotësuar kërkesat e Nenit 9/3 të Ligjit 10352, datë 18.11.2010 ÷Për artin dhe Kulturën, i ndryshuar, i cili parashikon se ÷Emërimi i titullarit të institucionit publik qendror bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave pas procedurave të konkurrimit të zhvilluara nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën. (Më hollësisht trajtuar në faqet (33-34) të Raportit të Auditimit)

**6.1 Rekomandimi:** Ministri i Kulturës të marrë masa për të çelur dhe zhvilluar procedurën e konkurrimit për zgjedhjen e Drejtorit të Cirkut Kombëtar dhe propozimin e kandidaturës fituese pranë Këshillit të Ministrave për emërim, në përputhje me nenin 9/3 të Ligjit 10352, datë 18.11.2010 ÷Për artin dhe Kulturën, i ndryshuar.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Grupi i auditimit gjatë auditimit në terren, pas këqyrjes së ambienteve ku ka qenë e vendosur Çadra e Cirkut, me procesverbalin e mbajtur në datë 17.11.2021, në prani të personit i cili e ka pasur në ngarkim, z. K.Z. (mekanik), ka konstatuar fizikisht se sistemi i ngrohjes, konkretisht pjesa e djegies së karburantit nuk ndodhet në ambientet e Cirkut Kombëtar. Referuar inventarit të mallrave, të vitit 2020 rezulton se sistemi i ngrohjes së institucionit është në vlerën 957,659 lekë. Personi i cili e ka pasur në ngarkim, sipas fletës së inventarit të datës 04.05.2012, evidenton në procesverbal se nuk ka dijeni se ku ndodhet pjesa e djegies së karburantit të sistemit të ngrohjes. Deri në momentin e kryerjes së procesit auditues, në asnjë rast nuk është njoftuar në lidhje me mungesën e pjesës së djegies së sistemit të ngrohjes nga personi që e ka patur në ngarkim Z. K.Z..

Këto veprime janë në shkelje të Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 8, neni 22, neni 24. Udhëzimin nr. 30, datë ÷Për menaxhimin e aktiveve, pika 5, 10,11,21. *(Më hollësisht trajtuar në faqen (31-32) të Raportit të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Kulturës dhe Cirkut Kombëtar të marrin të gjitha procedurat ligjore për evidentimin e vlerës së pjesës së djegies së karburantit, e cila mungon dhe arkëtimin e vlerës nga personat të cilët kanë patur përgjegjësi për ruajtjen.

Menjëherë

## **C. MASA DISIPLINORE**

### **C.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE**

**C.1.1.** Për punonjësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil, mbështetur në nenet 57-60 të Ligjit nr. 153/2013 ÷Për nëpunësin civil dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 ÷Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

- Për **Znj. J.S.**, me detyrë Specialiste në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në Ministrinë e Kulturës;

Për moszbatim të përcaktimeve të pikës 3 të nenit 46 të Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, në lidhje me përfaqësimin në gjykatë për procesin gjyqësor me palë paditëse Shoqëria ÷Uö shpk dhe palë e paditur Cirkut Kombëtar.

### **C.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte ndërprerje e marrëdhënieve të punës përkatësisht:

- Për **Z. I.GJ.**, me detyrë Drejtor i Cirkut Kombëtar, liruar nga detyra me VKM-në nr. 790, datë 15.12.2021, me propozim të Ministrit të Kulturës. *(Më hollësisht trajtuar në faqet (38-39) të Raportit të Auditimit)*

## **VI. ANEKSE**

### *Viti 2019*

<b>Nr</b>	<b>Muaji</b>	<b>Pagesat Bruto (në lekë)</b>
1	Janar	2,378,024
2	Shkurt	2,340,148
3	Mars	2,312,374
4	Prill	2,293,181
5	Maj	2,293,601
6	Qershor	2,284,116
7	Korrik	2,367,661
8	Gusht	2,367,941
9	Shtator	2,368,221
10	Tetor	2,525,410
11	Nëntor	2,595,011
12	Dhjetor	2,475,071
	<b>Totali</b>	<b>28,600,759</b>

### *Viti 2020*

<b>Nr</b>	<b>Muaji</b>	<b>Pagesat Bruto (në lekë)</b>
1	Janar	2,635,168
2	Shkurt	2,708,500
3	Mars	2,679,583
4	Prill	2,640,913
5	Maj	2,589,932
6	Qershor	2,629,514
7	Korrik	2,634,044
8	Gusht	2,634,324
9	Shtator	2,634,604
10	Tetor	2,661,838
11	Nëntor	2,694,393
12	Dhjetor	2,669,753
	<b>Totali</b>	<b>31,812,566</b>

## **VII. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT**

### **a. Akt Konstatime:**

- Akt Konstatimi Nr. 1 datë 24.11.2021 òMbi auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës dhe Cirkun Kombëtar, në zbatim të autorizimit nr. 1129/2 Prot., datë 25.10.2021 dhe autorizimit nr. 1129/4 Prot., datë 12.11.2021 të Kryetarit të KLSH-sëo;
- Akt Konstatimi Nr. 2 datë 24.11.2021 òMbi auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës dhe Cirkun Kombëtar, në zbatim të autorizimit nr. 1129/2 Prot., datë 25.10.2021 dhe autorizimit nr. 1129/4 Prot., datë 12.11.2021 të Kryetarit të KLSH-sëo.

Për sa më sipër paraqitet ky raport auditimi.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**